

TRANSPARENCA E BOTIMEVE ZYRTARE NE REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, 2010

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.qpz.gov.al

Nr.152

18 nëntor

2010

PËRMBAJTJA

Faqe

Ligj nr. 10.335
datë 14.10.2010

Për ratifikimin e " Marrëveshjes së financimit ndërmjet
Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe
Komisionit të Komuniteteve Evropiane "Për programin e
financimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programet
transnacionale ERDF të objektivit të bashkëpunimit
territorial evropian "Europa Juglindore dhe Mesdheore"
Instrumentit të Ndihmës së Paraadefinitit (IPA), të
bashkëpunimit ndërkufitar për vitin 2009".....

8061

Vendim i KM
nr.822, datë 6.10.2010

Për disa shëna dhe ndryshime në
23.12.2009 të Këshillit të Ministrave të
kriterëve bazë të sektorëve që
masave të përfuturit nga fondi i punës
zhvillimit rural", të ndryshuar.....

8075

Vendim i KM
nr.824, datë 13.10.2010

Për pjesëmarrjen në shërbime të dy kompanive
tokësore të Forcave të Armatosura të
Shqipërisë, në Qendrën e Bashkëpunimit
Gatishmërisë (MRC), në Hohenheim.....

Vendim i KM
nr.826, datë 13.10.2010

Për kuotat e pranimeve në institucionet
të lartë dhe tarifat e shkolimit për studentët e ciklit të
kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë,
akademik 2010 - 2011.....

8076

Vendim i KM
nr.827, datë 6.10.2010

Për disa ndryshime në vendimin nr.488, datë 23.4.2008 të
Këshillit të Ministrave Për kalimin në përgjegjësi
administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të pronës së
paluajtshme nr.663, truall, ish-reparti ushtarak i artilerisë,
nr.6650 në Parangua, Berat, si dhe për një ndryshim në
vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave
"Për miratimin e listës së inventarit të pronës së
paluajtshme shtetërore, të cilat janë në
administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes".....

8082

RAPORTI MONITORUES

ANALIZA 5-VJEÇARE E
BOTUESHMËRISË SË AKTEVE



RAPORTI MONITORUES, 2010

TRANSPARENCA E BOTIMEVE ZYRTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

DHE

ANALIZA 5-VJEÇARE E
BOTUESHMËRISË SË AKTEVE
2006-2010

Realizuar nga:



Financuar nga:



Botim i Qendrës për Çështjet e Informimit Publik, ÇIP



Website: www.infocip.org
e mail: qendra@cip-al.org

© copyright 2011 - Autori

U realizua në kuadër të projektit

“Pergatitja dhe shpallja e Raportit Vjetor 2010 për transparencën e botimeve zyrtare në Republikën e Shqipërisë dhe përcaktimi i nivelit të implementimit të ligjit përmes analizës së të dhënave të mbledhura nga 2006-2010.”

Grupi i punës:

Gerti Shella, drejtor projekti
Eniel Kolaneci, ekspert ligjor
Endri Shabani, ekspert ligjor
Anduena Manushi
Anisa Papadhima
Anila Aliraj

Redaktor i studimit (shqip & anglisht):

Gerti Shella

Design & Layout:

Dritan Lleshi

* * *

Financuar nga:



Ky projekt është mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) në kuadër të programit të Mirëqeverisjes dhe Integritetit. Mendimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të OSFA-s.

PËRMBAJTJA

PJESA E PARË

TRANSPARENCA E BOTIMEVE ZYRTARE, 2010	9
---	---

KAPITULLI 1 - PUSHTETI LEGJISLATIV	10
---	----

Ligje të Kuvendit të Shqipërisë	11
---------------------------------------	----

KAPITULLI 2 - AKTET NDERKOMBËTARE	12
--	----

Teksti në shqip i akteve ndërkombëtare	13
--	----

KAPITULLI 3 - PUSHTETI EKZEKUTIV	14
---	----

Akte Normative me Fuqinë e Ligjit të KM	15
---	----

Vendime të Këshillit të Ministrave, VKM	16
---	----

Udhëzime të KM dhe ministrave	18
-------------------------------------	----

Udhëzime të Këshillit të Ministrave (KM)	19
--	----

Udhëzime të Ministrisë së Financave (MF)	20
--	----

Udhëzime të Ministrisë së Arsimit (MASH)	21
--	----

Udhëzime të Ministrisë së Transporteve (MPPT)	22
---	----

Udhëzime të Ministrisë së Mjedisit (MMPAU)	23
--	----

Udhëzime të Ministrisë së Bujqësisë (MBUMK)	24
---	----

Udhëzime të Ministrisë së Brendshme (MB)	25
--	----

Udhëzime të Ministrisë së Drejtësisë (MD)	26
---	----

Udhëzime të Ministrisë së Punës (MPÇSSHB)	26
---	----

Udhëzime të Ministrisë së Ekonomisë (METE)	26
--	----

Udhëzime të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH)	26
--	----

KAPITULLI 4 - PUSHTETI GJYQËSOR	28
--	----

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë	29
--	----

KAPITULLI 5 - GJYKATA KUSHTETUESE	30
--	----

Vendime të Gjykatës Kushtetuese	31
---------------------------------------	----

KAPITULLI 6 - GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT (GJEDNJ) NË STRASBURG	32
---	----

Vendime të GJEDNJ	33
-------------------------	----

PJESA E DYTË

BOTUESHMËRIA E AKTEVE, 2006-2010	35
--	----

KAPITULLI 7 - MBI NIVELIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE	36
--	----

Ligjet e Kuvendit	37
-------------------------	----

KAPITULLI 8 - MBI AKTET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE	38
--	----

Vendime të Këshillit të Ministrave	39
--	----

Akte Normative me Fuqinë e Ligjit	41
---	----

KAPITULLI 9 - MBI BOTUESHMËRINË E UDHËZIMEVE	42
---	----

Udhëzime të Këshillit të Ministrave	44
---	----

Udhëzime të Ministrisë së Financave	45
---	----

Udhëzime të Ministrisë së Arsimit	46
---	----

Udhëzime të Ministrisë së Transporteve	47
--	----

Udhëzime të Ministrisë së Mjedisit	48
--	----

Udhëzime të Ministrisë së Bujqësisë	49
---	----

Vendimet Unifikuese të Gjykatës së Lartë	50
--	----

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese	53
---------------------------------------	----

KAPITULLI 10 - REKOMANDIME	54
---	----

KAPITULLI 11 - SHKURT MBI METODOLOGJINË "ÇIP"	56
--	----

ANEKS SPECIAL - TABELAT E VKM-ve, 2010	57
---	----

LISTA E SHKURTIMEVE

- ANFL** – Akt Normativ me Fuqinë e Ligjit i Këshillit të Ministrave
- AP** – Avokati i Popullit
- FZ** – Fletore Zyrtare
- GJEDNJ** – Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
- GJK** – Gjykata Kushtetuese
- GJL** – Gjykata e Lartë
- KiE** – Këshilli i Europës
- KM** – Këshilli i Ministrave
- MASH** – Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- MB** – Ministria e Brendshme
- MBUMK** – Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
- MD** – Ministria e Drejtësisë
- METE** – Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës
- MF** – Ministria e Financave
- MMPAU** – Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
- MPCSSHB** – Ministria e Punëve, Çështjeve Sociale dhe e Shanseve të Barabarta
- MPPTT** – Ministria e Punëve Publike, Transport, Telekomunikacioneve
- MSH** – Ministria e Shëndetësisë
- QPZ** – Qendra e Publikimeve Zyrtare
- VGJK** – Vendim i Gjykatës Kushtetuese
- VKM** – Vendim i Këshillit të Ministrave
- VUGJL** – Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë



HYRJE

Raporti vjetor "Transparenca e Botimeve Zyrtare në Republikën e Shqipërisë", vjen përpara publikut shqiptar dhe institucioneve të shtetit për të tretin vit rradhazi. **Raporti 2010** u përgatit nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, ÇIP, falë mbështetjes së rëndësishme të ofruar nga OSFA (Fondacioni Soros).

Objekt monitorimi dhe vlerësimi i këtij Raportit është botimi i akteve të institucioneve qëndrore kushtetuese në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Risia e **Raportit 2010**, është se në të përfshihet edhe një vlerësim i detajuar i **nivelit të botueshmërisë së akteve** gjatë periudhës 5-vjeçare, 2006-2010. Një vlerësim i tillë për aksesin në legjislacion në RSH realizohet për herë të parë dhe është unik. Ai bazohet në gjetjet e Raporteve të Trasparencës së Botimeve Zyrtare për 5 vitet e fundit. ÇIP ka përllogaritur edhe **nivelin e zbatueshmërisë së ligjit** nga vetë institucionet që nxjerrin akte. Konkretisht, objekt vlerësimi në këtë drejtim është zbatimi (implementimi) i dispozitave të ligjeve organike (ose të vetë Kushtetutës) që caktojnë detyrimin për botim në Fletore Zyrtare të akteve që nxjerrin institucionet qëndrore kushtetuese të të treja pushteteve, Legjislativit, Ekzekutivit dhe Gjyqësorit.

Kjo përllogaritje e nivelit të zbatueshmërisë së këtyre dispozitave ofrohet në përqindje. Metoda e përdorur mund të shërbejë si model edhe për aktorë të tjerë të interesuar në përllogaritjen objektivë të nivelit të zbatimit të ligjeve apo dispozitave të veçanta që janë objekt i punës së tyre.

ÇIP ka përpunuar grafikisht gjetjet mbi botueshmërinë e akteve dhe zbatueshmërinë e dispozitave që caktojnë detyrimin për botim të akteve, me synim vizualizimin e trendit (përkeqësues apo përmirësues) gjatë 5 viteve të fundit, sipas llojit të aktit dhe për secilin institucion.

Monitorimin e këtij viti, autorët do të parapëlqenin ta konsideronin si një raport auditi 5-vjeçar për sistemin e publikimeve zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Ai ofron një panoramë mëse të qartë të problemeve të hasura, kurse shifrat dhe grafiket orientojnë se ku nevojiten ndërhyrje konkrete.

Ky raport ka si target të natyrshëm Qendrën e Publikimeve Zyrtare, pa përjashtuar edhe të gjitha institucionet qëndrore, të cilat ngarkohen nga ligji për të botuar aktet e tyre në Fletore Zyrtare. Në shpresojmë që aktet e identifikuara si të pabotuara prej këtij Raporti, të botohen në numra ekstra të Fletores Zyrtare, pasi QPZ të kryejë të gjitha verifikimet dhe vlerësimet përkatëse mbi objektivitetin e tyre. Është me vend të theksohet që në hyrje se, institucionet e shtetit shqiptar kanë hedhur hapa të rëndësishëm përpara sa i takon konsolidimit të sistemit të Botimeve Zyrtare.

Teksa ndihmesa e donatorëve ka qenë mëse bujare në këtë drejtim, një punë e lavdërueshme është bërë në këto vitet e fundit nga vetë QPZ, jo vetëm sa i takon botimit në Fletore Zyrtare të akteve që i dërgohen, por edhe për të pakësuar stokun e akteve të lëna jashtë botimi ndër vite përmes procesimit të tyre në Fletore Zyrtare Ekstra.

Raporti **"Transparenca e Botimeve Zyrtare në RSH, 2010"** publikohet kur mbeten dhe më pak se dy vite (gjysma e kohës së parashikuar) për implementimin e Strategjisë Ndërsektoriale në Administratën Publike (SNRAP), '09-'13. Pjesë e vizionit qeverisës, të shprehur në këtë dokument të rëndësishëm është *"një administratë që bazohet në procese vendimarrëse transparente, përfshirëse dhe të përgjegjshme ndaj publikut"*. Gjetjet e këtij Raporti, sidomos analiza krahasuese e të dhënave për periudhën 2006-2010, ofrojnë një mundësi më shumë për vlerësimin e realizimit të objektivave të shprehura në kuadër të SNRAP, sidomos sa i takon *"procese vendimarrëse transparente"*.

Për më tepër, ky Raport bëhet publik në një kohë kur Qeveria shqiptare i është bashkuar edhe nismave globale që synojnë rritjen e transparencës në procesin vendimarrës, sikurse është edhe Partneriteti për Qeverinë e Hapur (Open Government Partnership). OGP, të cilës Shqipëria iu bashkua më 2 Gusht 2011, bazohet në Iniciativën për Qeverisje të Hapur të presidentit të SHBA, Obama, lançuar ditën e tij të parë në detyrë, më 20 Janar 2009, **për ta bërë qeverinë transparente, pjesëmarrëse dhe bashkëpunuese**.

Qendra ÇIP, si një operator i shoqërisë civile i specializuar në fushën e aksesit në legjislacion dhe transparencës së botimeve zyrtare, i përmbahet motos se **"Shqiptarët duhet ta dinë se çfarë vendimesh merren në emër të tyre"**. Aktet zyrtare janë një aset kombëtar me vlerë të pazëvendësueshme, dhe si të tilla ato duhet të jetë në përdorim dhe të aksesueshme efektivisht prej të gjithë shqiptarëve. Aksesin në legjislacion është një e drejtë që duhet të gëzohet prej kujtdo, dhe jo vetëm prej atyre që kanë kohën, apo mjetet e nevojshme në dispozicion. Në këtë kuptim, ai është një tregues i drejtpërdrejtë i vlerësimit të angazhimeve të marra përsipër tashmë si brenda vendit, ashtu edhe në nivel global nga Qeveria shqiptare.

Për më tepër, shpallja e akteve përmes botimit përbën një nga parimet themelore të shtetit. Ky parim afirmon kushtin që, përpara se subjekteve t'i kërkohet nga shteti të zbatojnë normën, si fillim ata duhet të njoftohen që kjo normë ekziston dhe ka hyrë në fuqi. Ky është një kusht themelor për të patur një qeverisje transparente dhe të përgjegjshme.

Gerti Shella
Drejtor i projektit

Falenderime

Qendra për Çështje të Informimit Publik, ÇIP, falenderon Fondacionin *Shoqëria e Hapur për Shqipërinë*, SOROS, për besimin dhe ndihmesën mjaft të rëndësishme që ka ofruar për realizimin e kësaj nisme. **“Transparenca e Botimeve Zyrtare në Republikën e Shqipërisë”** nuk do kishte qenë e mundur pa mbështetjen e këtij Fondacioni dhe stafit të tij profesional dhe të përkushtuar.

ÇIP falenderon gjithashtu me mirënjohje edhe National Endowment for Democracy, NED, me seli në Washington D.C, ndihmesa e të cilit ishte përcaktuese për konsolidimin e këtij monitorimi.

Një falenderim special shkon edhe për vetë stafin e ÇIP, i cili në këto 4 vite arriti të adresojë për zgjidhje dhjetëra probleme metodologjike dhe empirike gjatë implementimit të projektit, pavarësisht trysnisë së madhe të shkaktuar nga vulumet e jashtëzakonshme të akteve që u shqyrtuan apo peshës së përgjegjësisë përballë opinionit publik dhe insitucioneve qëndrore, lidhur me gjetjet e prezantuar.

Një falenderim i fundit i takon institucioneve shtetërore, të cilat kanë pritur me interesim dhe qëndrim profesional konkluzionet dhe rekomandimet e Raporteve të përvitshme të Transparencës së Botimeve Zyrtare në RSH. Një pjesë e këtyre institucioneve, kanë reflektuar më së miri në punë e tyre këto rekomandime, duke u paraqitur nga viti në vit me performancë të përmirësuar sa i takon botimit të akteve të tyre në Fletore Zyrtare, sikurse sugjerojnë edhe grafikët në pjesën e dytë të këtij publikimi.



PJESA E PARË

TRANSPARENCA E BOTIMEVE ZYRTARE, 2010



Pjesa e Parë e këtij publikimi i është rezervuar Raportit vjetor: **"Transparenca e Botimeve Zyrtare, 2010"**. Objekt monitorimi dhe vlerësimi në kuadër të këtij Raporti është botimi i akteve të institucioneve qendrore kushtetuese në Fletoren Zyrtare gjatë vitit 2010.

Sikurse edhe vitet e kaluara, Raporti i 2010-ës fokusohet tek ato akte, botimi i të cilave në Fletore Zyrtare është i detyrueshëm me ligj. Legjitimiteti (baza ligjore relevante) ku mbështen gjetjet e Raportit 2010 janë parashtruar në mënyrë konçize në fillim të çdo kapitulli. Përcaktimi i legjitimitetit bazohet në vlerësimin e dyfishtë si të dispozitave të ligjeve organike që caktojnë detyrimin për botim të akteve për secilin institucion qendror, ashtu edhe në ligjin nr.8502, dt. 30.6.1999, "Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare", të ndryshuar me ligjin nr. 9091, dt. 26.6.2003.

Në kuadër të Raportit 2010, ÇIP gjithashtu ka monitoruar sërish rregullsinë e botimit në Fletore Zyrtare të vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Botimi i tekstit të plotë të vendimeve të GJEDNJ, me palë të paditur shtetin shqiptar, është një praktikë që ndiqet nga Shqipëria në kuadër të Rekomandimit (2002) 13 të Komitetit të Ministrave të KiE. Vlen të theksohet se, sikurse implikon edhe vetë termi "Rekomandim", botimi i vendimeve të GJEDNJ nuk është një detyrim ligjor që buron nga sistemi i brendshëm juridik i Republikës së Shqipërisë. Sa i takon vendimeve të Gjykatës Kushtetuese si dhe vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë (VUGJL), objekt vlerësimi në kuadër të këtij Ra-

porti është edhe afati kohor i botimit të tyre në Fletore Zyrtare.

Raporti **"Transparenca e Botimeve Zyrtare, 2010"** përmban një kapitull të posaçëm ÇIP ku vlrësohet edhe botimin në FZ i tekstit në shqip të marrveshjeve ndërkombëtare të ratifikuar nga Kuvendi gjatë vitit 2010. Në këtë kontekst, ÇIP ka bërë edhe një vlerësimin mbi problematikën e **"stokut"** të akteve ndërkombëtare të pabotuara në shqip, situatë kjo e mbartur nga vitet e kaluara. Volumi i këtij "stoku" për momentin, konsiston vetëm në gjetjet që ka paraqitur Avokati i Popullit në Kuvend, përmes Raportit Special nr. 1, dt 23/05/2008. (Në vlerësimet paraprake që ÇIP ka ndërmarrë në këtë drejtim, rezulton se volumi i këtij stoku është shumë herë më i madh se sa ai i identifikuar nga AP).

Sa i takon mënyrës së organizimit të gjetjeve të **Raportit 2010**, autorët kanë bërë kujdes që ato të paraqiten në një mënyrë sa më të kuptueshme, jo vetëm për ata që kanë një interes profesional në leximin e rezultateve, por edhe për median, madje dhe për ata që nuk do të konsideroheshin "profesionistë të fushës".

Për të mundësuar një lexim **"të shkathët"** të Raportit, konkluzionet e monitorimit për secilin lloj akti paraqiten mbi një sfond të ngjyrosur (*banner*) brenda hapësirës së faqes. Një rezultat pozitiv vendoset në një *banner* të gjelbër, kurse një rezultat negativ në një *banner* me ngjyrë portokalli. Për çdo element alternativ, që ka të bëjë me formën dhe formatin e prezantimit të tabelave të rezultateve, fajta është e pajisur me legjendë të posaçme.



PUSHTETI LEGJISLATIV

Shqipëria është një Republikë Parlamentare (neni 1 i Kushtetutës së Shqipërisë). Përgjithësisht, Kuvendi referohet ose identifikohet si institucioni më i lartë i shtetit. Megjithatë, Kushtetuta nuk ka ndonjë përkufizim për rolin dhe funksionet e Kuvendit apo për pozitën e epërme që ka ai në raport me organet e tjera kushtetuese¹.

Veprimtaria e Kuvendit të Shqipërisë rregullohet nga Rregullorja e Kuvendit, e cila miratohet nga vetë Kuvendi, sipas parimit të njohur dhe të aplikuar në vendet demokratike se “ligjvënësi (parlamenti) është zot i caktimit të rregullave të veta”².

Në ushtrim të pushtetit të tij ligjvënës, Kuvendi nxjerr disa lloje aktesh, mes të cilave ligje, vendime, rezoluta dhe deklarata. (Neni 106 i Rregullores së Kuvendit).

Nga të gjitha llojet e akteve që nxjerr Kuvendi, në fokus të këtij monitorimi do të jenë vetëm ligjet, të cilat qëndrojnë në majën e hierarkisë së dokumentave parlamentare. Ligjet janë qëllimi parësor dhe produkti përfundimtar i procesit ligjvënës. Si akt normativ, ligji përfaqëson një sistem normash juridike që rregullojnë në formë të përgjithshme, marrëdhënie shoqërore të rëndësishme.

Kushtetuta e Shqipërisë i ka kushtuar një rëndësi të posaçme procesit ligjvënës, ku një moment kyç është edhe mënyra e hyrjes në fuqi të ligjeve. Në pjesën e tretë të Kushtetutës, kreu IV, nenin 84/3 thuhet se: “ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare”. Kjo është edhe procedura e zakonshme e hyrjes në fuqi të ligjit. Paragrafi 4 i nenit 84 parashikon edhe një procedurë të jashtëzakonshme të hyrjes në fuqi të ligjit dhe

konkretisht: “Në rastet e masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevojë dhe urgjence, kur Kuvendi vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve dhe Presidenti i Republikës jep pëlqimin, ligji hyn në fuqi menjëherë, vetëm pasi të jetë njoftuar publikisht. Ligji duhet të botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare”. Pra, që një ligj të hyjë në fuqi menjëherë duhet të plotësohen tre kushte kumulative:

- 1) Kuvendi të vendosë me shumicën e të gjithë anëtarëve;
- 2) Presidenti i Republikës të japë pëlqimin;
- 3) Ligji të jetë njoftuar publikisht.

Edhe neni 117 i Kushtetutës së Shqipërisë përcakton në pikën 1 të tij se: “Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, ministrave, të institucioneve të tjera qëndrore marrin fuqi juridike vetëm pasi të botohen në Fletoren Zyrtare.”

Nga i gjithë parashtrimi i mësipërm, është e qartë se mos-botimi i ligjeve në Fletore Zyrtare do të shkaktojë *a-priori* mos-hyrjen e tyre në fuqi. Mos-botimi i akteve normative në Fletore Zyrtare, në kuptimin strikt juridik, do të thotë se ato nuk ekzistojnë³. Përderisa nuk ekzistojnë, ato nuk prodhojnë detyrim ndaj subjekteve për t’u zbatuar apo ndjekur prej tyre.

Parimi sipas të cilit *ignorantia juris non excusat* (injo-ranca ndaj ligjit nuk shfajëson (në gjykatë)), humbet kuptimin në një rast të tillë për shkak të mos-përm-bushjes së parimit që i paraprin, sipas të cilit “nuk mund të përfitosh apo dëmtoresh nga një ndalim apo lejim i ligjit në rast se nuk ke mundësi reale apo formale të njohjes me ligjin”. Botimi i ligjeve dhe akteve të tjera zyrtare në Fletore Zyrtare prezumon faktin që të gjithë njerëzit janë vënë në dijeni të këtyre akteve.

1 “E Drejta Kushtetuese” Luan Omari; Aurela Anastasi, ribotim 2010, fq.194

2 “E Drejta Kushtetuese” Luan Omari; Aurela Anastasi, ribotim 2010, fq.235

3 “E Drejta Administrative 2” Sokol Sadushi, botimi i tretë i ripunuar 2005, fq.55



REZULTATET E MONITORIMIT, 2010

Ligje të Kuvendit të Shqipërisë

Në Fletore Zyrtare 2010 (1 Janar-31 Dhjetor), gjenden të botuara gjithsej 156 ligje.

Serinë e hap me: **Ligji nr.10212, datë 21.01.2010** – Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim policor dhe ndërkufitar”.
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 9, faqe 293, data e botimit: 15-02-2010)

dhe e mbyll: **Ligji nr.10367, datë 23.12.2010** – Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.5, datë 10.11.2010, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura ...”
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 181, faqe 10120, data e botimit: dhjetor 2010)

Pas verifikimeve
rezultoi se:



gjatë vitit 2010, janë botuar në Fletore Zyrtare të gjitha ligjet e miratuara nga Kuvendi

Konstatime ekstra:

Nga totali prej 156 ligjesh të miratuara dhe të botuara në Fletore Zyrtare, 4 prej tyre kanë të përcaktuar në dispozitën e fundit se “hyjnë në fuqi menjëherë”. Nga verifikimi rezultoi se, për këto 4 ligje, janë përmbushur rigorozisht **tre kushtet kumulative** që parashikon Kushtetuta në mënyrë që ato të hyjnë në fuqi menjëherë, konkretisht:

- 1) Kuvendi ka vendosur me shumicën e të gjithë anëtarëve;
- 2) Presidenti ka dhënë pëlqimin me dekret të posaçëm për hyrjen në fuqi menjëherë;
- 3) ligji është njoftuar publikisht;

Konstatohet se, për ligjet nr. 10336, 10267, 10254 shpallja me dekret nga Presidenti (përfshirë dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë) dhe botimi në Fletore Zyrtare janë bërë një ditë pas miratimit nga Kuvendi.

Kurse, për ligjin nr. 10276 konstatohet se miratimi nga Kuvendi është bërë më dt 06.05.2010, shpallja me dekret nga Presidenti është bërë më dt 10.05.2010, kurse botimi në Fletore Zyrtare është bërë më dt. 21.05.2010. Ky ligj ratifikon një marrëveshje midis Republikës së Shqipëris dhe disa institucioneve financiare (Deutsche Bank AG, London e J.P Morgan Securites) për manaxhimin e përkohshëm të Eurobondit deri në 400 milion Euro.



AKTET NDERKOMBËTARE

Kushtetuta e Shqipërisë i ka kushtuar një vëmendje të posaçme procesit të lidhjes së traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. Në pjesën e parë të saj, “Parime Themelore”, ajo përcakton se “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të” (Neni 5).

Në fushën e të drejtave të njeriut, Kushtetuta ka futur drejtpërdrejtë në veprim Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, duke e ngritur në nivelin e normës kushtetuese teksa thekson se “kufizimet e të drejtave dhe lirive nuk mund të tejkalojnë në asnjë rast kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut” (neni 17/2).

Marrëveshjet ndërkombëtare renditen të dytat pas Kushtetutës në hierarkinë e akteve normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (neni 116/1). Botimi i tekstit të tyre është detyrim kushtetues dhe ligjor pasi, në bazë të nenit 117/3 të Kushtetutës: “Marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen me ligj, shpallen dhe botohen sipas procedurave që parashikohen për ligjet. Shpallja dhe botimi i marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare bëhet sipas ligjit”.

Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë... (neni 122/1). Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të (neni 122/2).

Në mënyrë që të mundësohet zbatimi i një marrëveshjeje, sipas kuptimit të Kushtetutës, është e domosdoshme që, njësoj si edhe për ligjet, përmbajtja e këtyre akteve t’i bëhet e njohur në gjuhën shqipe (*deduksion logjik*) organeve të shtetit shqiptar si dhe të gjithë shtetasve shqiptarë.

Përpara 4 vjetësh, Avokati i Popullit (AP) ka konstatuar se një numër relativisht i madh aktesh ndërkombëtare që Shqipëria ka nënshkruar apo ka aderuar,

para dhe pas viti 1990, nuk janë ende të botuara në Fletore Zyrtare. AP konstatonte se problemi vijonte të mbetej i pazgjidhur për 75 akte ndërkombëtare të identifikuar që në vitin 2002.

AP, çmonte se “është shumë i rëndësishëm botimi i teksteve të të gjitha akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, para dhe pas vitit 1990, të cilat janë bërë pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm dhe, si rrjedhim, janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga institucionet e shtetit shqiptar, në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë”.

Duke e njohur dhe pranuar si të mirëqenë problemin në fjalë, Qendra ÇIP, në kuadër të Raportit për vitin 2009, ndërmori një verifikim për të parë se sa ishte reduktuar “stoku” i këtyre akteve përmes botimit të teksteve të tyre (në shqip) në Fletore Zyrtare Ekstra. Meqënëse, Raporti Special nr.1 i AP mban datën 23/05/2008, atëherë ÇIP u fokusua në hulumtimin e të gjitha FZ Eksta të nxjerra që nga 2008-a (7 gjithsej) e deri në fund të 2009-ës (6 gjithsej).

Nga hulumtimi një për një i tyre, rezultoi të ishte botuar në gjuhën zyrtare shqipe vetëm teksti i Konventës **“Mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (OKB)**. Botimi i saj është bërë në FZ Ekstra 33, dt. 15/10/2008, pra rreth 5 muaj pas dërgimit në Kuvend të Reportit Special Nr.1 nga AP. Rreth 15 ditë para se AP të dorëzonte në Kuvend Raportin Special nr. 1, QPZ botoi në FZ Ekstra 28 dhe 29 tekstin shqip të **“Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”**, të KE, bashku me protokollet shtesë të saj (15 në total).

Edhe në kuadër të këtij Raporti për vitin 2010, ÇIP ka përfshirë vlerësimin e situatës sa i takon reduktimit të “stokut” të akteve ndërkombëtare, i cili është mbartur nga vitet e kaluara (deri para 2007-ës). Ky stok, për momentin, konsiston vetëm në gjetjet që AP ka reklamuar në Kuvend përmes Raportit Special nr. 1.



REZULTATET E MONITORIMIT, 2010

Teksti në shqip i akteve ndërkombëtare

Botimi i tekstit në shqip të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara me ligj gjatë vitit 2010 paraqet një panoramë të normalizuar plotësisht.

Nga hulumtimi i Fletoreve Zyrtare 2010, rezultojnë të botuara 62 ligje që ratifikojnë akte ndërkombëtare. Për të folur në terma më konkretë, në Fletore Zyrtare gjenden të botuara 9 ligje që ratifikojnë aderimin e

Shqipërisë në konventa, 4 ligje për ratifikimin e nëshkrimit të protokolleve si edhe 49 ligje që ratifikojnë nënshkrim marrëveshjesh ndërkombëtare, memorandum, statute dhe traktate.

Të gjitha ligjet e mësipërme janë të botuara në FZ, bashkëshoqëruar nga teksti i marrëveshjes përkatëse i përkthyer zyrtarisht në shqip.


Si konkluzion:

gjatë 2010-ës, janë botuar në FZ të gjitha tekstet shqip të marrëveshjeve ndërkombëtare që ka ratifikuar me ligj Kuvendi i Shqipërisë

"Stoku" i akteve ndërkombëtare të pabotura

Praktika sugjeron se aktet "stok" të pabotuara, trajtohen për botim në FZ Ekstra. Kjo do të thotë se për të vlerësuar nëse "stoku" i akteve ndërkombëtare të ratifikuara, për të cilat AP ka konstatuar se nuk janë të botuara si tekst shqip në FZ, është pakësuar apo vijon të mbetet i paprekur, monitorimi përqëndrohet në shqyrtimin një për një të Fletoreve Zyrtare Ekstra të cilat janë nxjerrë nga QPZ gjatë 2010-ës. Rezulton se gjatë këtij viti, QPZ ka nxjerrë gjithsej 30 FZ Ekstra. Në asnjërën prej tyre (FZ Ekstra 2010) nuk ka tekste të ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare që të jetë ratifikuar para datës 23/05/2008, kur AP dorëzoi në Kuvend Raportin Special nr.1.

Si përfundim, sa i takon reduktimit të "stokut" të marrëveshjeve ndërkombëtare, për të cilat AP konstatonte se janë të pa-botuara në FZ, viti 2010 nuk shënoi asnjë progres.



▲ Faksimile e Raportit Special Nr.1, datë 23.05.2008 të Avokatit të Popullit, "Për botimin në Fletoren Zyrtare të Akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar"



PUSHTETI EKZEKUTIV

Pushteti ekzekutiv në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga një tërësi organesh qendrore ose vendore, në krye të cilave qëndron Këshilli i Ministrave. Ai përbëhet nga Kryeministri, Zv.Kryeministri dhe nga Ministrat (neni 95 i Kushtetutës).

Këshilli i Ministrave përcakton drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore. Në ushtrim të pushtetit të vet ekzekutiv, ai nxjerr vendime dhe udhëzime (Neni 100 i Kushtetutës). Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative me fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme (neni 101 i Kushtetutës).

Aktet normative të Këshillit të Ministrave kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; ato renditen të katërtat në hierarkinë e akteve, konkretisht pas Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ligjeve (neni 116 i Kushtetutës).

Pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave është *propozimi i projektligjeve* (neni 81 i Kushtetutës) edhe *miratimet në parim të marrëveshjeve ndërkombëtare*. Të dyja këto lloj aktesh i dërgohen Kuvendit respektivisht për miratim, ose ratifikim (kur ratifikimi kërkohet nga dispozitat ligjore në fuqi). Këshilli i Ministrave ka gjithashtu kompetencë të lidhë marrëveshje të cilat nuk janë objekt ratifikimi nga Kuvendi.

Këshilli i Ministrave kryesohet nga kryetari i Këshillit të Ministrave (rëndom: *Kryeministri*). Kushtetuta i ka rezervuar një pozicion epërsie këtij të fundit në ushtrimin e funksioneve të drejtimit politik. Neni 102/1 gërma b sanksionon se “kryeministri koncepton dhe paraqet drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to”.

Kryeministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra, kurse ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime. (neni 102/ pika 3 & 4, i Kushtetutës).

Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Ministrave rregullohet me ligjin organik nr. 9000, dt. 30. 1. 2003. Ky ligj i kushton një rëndësi të posaçme në *kreun IV* të tij llojeve të akteve që nxjerrin organet qeveritare, mënyrës së hyrjes në fuqi dhe botimit të tyre në Fletore Zyrtare. Sipas nenit 29 të këtij ligji:

1. *Aktet normative, me fuqinë e ligjit, të Këshillit të Ministrave botohen menjëherë në Fletoren Zyrtare.*
2. *Vendimet e Këshillit të Ministrave marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare. Për vendimet me karakter normativ mund të caktohet si datë hyrjeje në fuqi një datë tjetër nga ajo e botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi menjëherë, por botohen në Fletoren Zyrtare.*
3. *Udhëzimet e Këshillit të Ministrave dhe të ministrit marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare.*
4. *Urdhrat e Kryeministrit, të ministrit ose të drejtuesit të institucionit qendror, në varësi të Kryeministrit ose të ministrit, hyjnë në fuqi menjëherë, u njoftohen të interesuarve dhe shpallen, për të paktën 3 ditë, në një vend të dukshëm të institucionit përkatës.*

Kjo do të thotë se, me përjashtim të *Urdhrave* (pika 4, neni 29), botimi i çdo akti të Këshillit të Ministrave dhe/apo ministrave në Fletoren Zyrtare është i detyrueshëm me ligj në çdo rast. Ligjvënësi është kujdesur që detyrimi ligjor për botimin në Fletore Zyrtare të akteve që nxjerr Këshilli i Ministrave (neni 29, ligji 9000) të mos lidhet domosdoshmërisht vetëm me caktimin e momentit të hyrjes në fuqi të aktit (sikurse do të ishte rasti për aktet me karakter normativ).



REZULTATET E MONITORIMIT, 2010

Akte Normative me Fuqinë e Ligjit të KM

Neni 101 i Kushtetutës, parashikon rastin kur Ekzekutivi merr attribute të Legjislativit, në mënyrë që “në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, të nxjerrë akte normative me fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mbledhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve”.

Hyrja në fuqi menjëherë e akteve normative me fuqinë e ligjit (për nga vetë natyra e aktit që nxirret në **kushte nevojë dhe urgjence**, pra kur “puna nuk pret” që të mbledhet Kuvendi për të nxjerrë ligj), implikon një çështje mjaft sensitive, sa kohë që e lë të hapur diskutimin se çfarë ndodh me pasojat e prodhuara menjëherë nga ky akt nëse Kuvendi e rrëzon (nuk e miraton) atë brenda 45 ditëve. As doktrina dhe as praktika kushtetuese në Shqipëri nuk kanë përcaktuar akoma

se çfarë duhen konsideruar “*raste nevojë dhe urgjence*”. Në kuadër të këtij Raporti, nuk do të ndalemi në diskutimin doktrinar mbi mënyrën e hyrjes në fuqi të aktit normativ me fuqinë e ligjit, për të cilin Gjykata Kushtetuese ka të paktën dy interpretime të saj.

Një gjë është e sigurtë: botimi në Fletoren Zyrtare i aktit normativ me fuqinë e ligjit është një kërkesë që rrjedh nga pika 1, neni 29, Ligji Nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, e cila përcakton shprehimisht se: “*Aktet normative, me fuqinë e ligjit, të Këshillit të Ministrave botohen menjëherë në Fletoren Zyrtare*”.

Aktet normative me fuqinë e ligjit të KM, indeksohen nga një varg numerik rritës me bazë kalendarike. Kjo do të thotë se seria e aktit hapet në fillim të çdo viti me numrin indeksues 1 dhe mbyllet nga numri rendor që merr ANFL e fundit për atë vit (deri më 31 dhjetor).

Seria e ANFL për 2010-ën hapet me:

Akt normativ Nr 1, Datë 05-05-2010 - Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar faqe 2227.
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 59, Faqe 2227; Data e botimit: 21-05-2010)

dhe mbyllet me:

Akt normativ Nr 6, Datë 22-12-2010 - Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10 190, datë 26-11-2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 173, Faqe 8878; Data e botimit: 24-12-2010)

Nga verifikimi rezultoi se :



në Fletore Zyrtare, 2010 janë botuar të gjitha (6) aktet normative me fuqinë e ligjit të KM





REZULTATET E MONITORIMIT, 2010

Vendime të Këshillit të Ministrave, VKM

Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM) indeksohen nga një varg numerik rritës me bazë kalendarike. Kjo do të thotë se seria e aktit hapet në fillim të çdo

viti me numrin indeksues "1" dhe mbyllet nga numri rendor që merr VKM e fundit për atë vit (deri më 31 Dhjetor).

Seria e VKM-ve për 2010-ën mbyllet me:

Vendim Nr 1081, Datë 29-12-2010, "Për përzgjedhjen e kompanisë austriake që do të përgatitë projektin e fisibilitetit në lidhje me projektet në fushën e teknologjisë së informacionit, që do të financohen në kuadër të bashkëpunimit financiar me Austrinë".
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 187, Faqe 10363; Data e botimit: dhjetor 2010)

Nisur nga rregulli i përgjithshëm i indeksimit të VKM-ve, rezulton se gjatë 2010-ës, Këshilli i Ministrave ka miratuar të paktën 1081 VKM.

Në Fletore Zyrtare 2010 gjendet të botuar *de-facto* 821 VKM. Nga ballfaqimi i kujdesshëm i përmbajtjes së FZ, lloji i aktit: VKM, me përmbajtjen e faqes zyrtare të KM u identifikuan 25 VKM standarte të nxjerra gjatë 2010-ës, të cilat gjenden online, por jo edhe në FZ

Në faqen zyrtare të KM u gjetën edhe 58 VKM që *miratojnë në parim* marrëveshje, prej të cilave, 4 janë të botuara në FZ, kurse 54 të tjera jo. Këshilli i Ministrave jep miratimin në parim për traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen në emër të shtetit ose të qeverisë (neni 5, ligji Nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare).

Edhe pse këto VKM si rregull pasohen nga akte të tjera¹, ligji 9000 "**Për organizimin dhe funksionimin e KM**" nuk bën në asnjë diferencim në dispozitat e tij për mos-botimin në FZ të këtyre VKM-ve tranzitore. Edhe praktika e vitit 2010 sugjeron se VKM-të "*për miratim në parim*" kanë qenë shpesh objekt botimi në Fletore Zyrtare nga QPZ. Konkretisht, në Fletoret Zyrtare të 2010-ës gjenden të botuara 17 VKM *për miratim në parim të marrëveshjeve*. Pavarësisht ndonjë argumenti² të hedhur, se botimi i këtyre lloj VKM-sh në FZ nuk është i domosdoshëm, pasi këto akte nuk janë përfundimtare³, autorët e këtij monitorimi, në vlerësimin e botueshmërisë për rastin në fjalë do t'i përmbahen në frymë dhe në gërmë përcaktimeve të nenit 29, të ligjit 9000 "**Për organizimin dhe funksionimin e KM**". Gjithsesi, për të respektuar argumentat alternativë mbi këtë çështje, gjetjet mbi VKM-të *për miratim në*

Si konkluzion faktik mund të thuhet se:

gjatë vitit 2010 nuk janë botuar në Fletore Zyrtare të paktën 25 VKM (me natyrë përfundimtare)

nga të paktën 71 VKM "për miratim në parim", 17 janë dërguar për botim në Fletore Zyrtare 2010

- 1 Këto akte të tjera mund të jenë ose VKM që i miratojnë përfundimisht VKM-të "për miratim në parim", kur kjo është kompetencë e vetë Qeverisë, ose VKM që propozojnë projektligje për ratifikimin e tyre në Kuvend, kur kjo është kompetencë e Kuvendit (neni 121/1 i Kushtetutës).
- 2 Disa juristë rsyetojnë se botimi në Fletore Zyrtare i VKM-ve që "miratojnë në parim marrëveshje", nuk është i domosdoshëm, sa kohë që implikohet domosdoshmërisht miratimi i akteve të mëvonshme për t'i materializuar këto. Në këtë kuptim, nisja e procesit legjislativ nuk implikon gjenerimin e efekteve legjislative, moment i cili lidhet me botimin e aktit definitiv në Fletore Zyrtare. Vetë ligji 9000 "për organizimin dhe funksionimin e KM dhe ministrave", i trajton si dy çështje të ndara hyrjen në fuqi të aktit përmes botimit dhe botimin në vetvete, i cili i shërben ndër të tjera marrjes së palëve të treat jo lehtësisht të identifikueshme, po aq sa edhe qeverisjes së mirë dhe transparente.
- 3 Një VKM "për miratim në parim" implikohet domosdoshmërisht miratimin e akteve të mëvonshme për t'i bërë ato përfundimtare (ose jo).



parim, do të organizohen në një tabelë të posaçme. Interpretimi nëse duhen konsideruar edhe këto si VKM të pabotuara në FZ, le të mbetet për momentin një prerogativ e gjithsecilit që dëshiron të përfshihet në këtë debat doktrinar, pasi të kenë parë me kujdes natyrën e këtyre akteve që ÇIP ka grupuar në "**tabelën legjendë**"

Ka vetëm një rast, në të cilin autorët e monitorimit bien dakort me praktikën e mos-botimit të VKM-ve (*jo-sekret*) në FZ dhe pikërisht atëherë kur Këshilli i Ministrave merr vendim *për propozim projektligji*. Në këtë rast, sikurse implikohet që në titullin e aktit, kemi të bëjmë me një propozim që Këshilli i Ministrave i bën Kuvendit në ushtrim të plotë të kompetencave të veta, të përcaktuar në Kushtetutë⁴.

Në shumicën e rasteve, një VKM *për miratim në parim të një marrveshjeje*, pasohet ose nga një VKM *për propozim projektligji* për ratifikim (nga Kuvendi) të lidhjes së kësaj marrëveshjeje (apo aderimit në të), ose nga një VKM *për miratimin e marrveshjes* nga vetë KM, kur kjo është brenda kompetencave të tij.

Në faqen e Këshillit të Ministrave gjenden të publikuara 69⁵ VKM *për propozim projektligji*, të cilat si rregull nuk dërgohen për botim në Fletore Zyrtare, pasi ato nuk kanë natyrë përfundimtare; ato thjesht i hapin rrugën Kuvendit për të thënë fjalën e vet.

Në përfundim të të gjitha përllogaritjeve, rezulton se nga totali prej 1081 VKM të nxjerra gjatë 2010-ës, vetëm 969 janë të identifikueshme si titull dhe si përmbajtje. Këtu përfshihen **821 VKM** të botuara në FZ, **25 VKM** standarte që janë në faqen zyrtare të KM, por jo në FZ, **54 VKM** "*për miratim në parim*", të cilat janë gjithashtu në faqen zyrtare të KM, por jo në FZ 2010 si dhe **69 VKM** "*për propozim projektligji*", të cilat, janë gjithashtu në faqen zyrtare, por, siç u shpjegua më sipër, nuk janë objekt botimi në Fletore Zyrtare.

Nga diferenca mes totalit të VKM-ve të miratuara

Viti	Totali i nxjerrë në 1 vit	VKM të botuara në FZ	VKM "për propozim projektligji"	VKM "për miratim në parim"	VKM të pabotuara gjetur nga ÇIP	VKM të botuara FZ Ekstra	Zona GRI
2010	1081	821	69	54	25	N/A	112


Tabelë legjendë

gjatë 2010-ës (1081) dhe atyre që janë të identifikueshme (atribute, titull dhe tekst), rezultojnë 112 VKM të cilat "i mungojnë apelit".

Ka tre mundësi teorike së çfarë mund të jenë këto 112 VKM që nuk gjenden të botuar as në faqen e KM e as në FZ 2010. Ato mund të jenë: ose **të gjitha VKM sekret**; ose **të gjitha VKM jo-sekret** (VKM standarte, miratime në parim apo propozim projektligji); ose **një kombinim i VKM-ve sekret dhe atyre jo-sekret**.

Në këtë pikë, Metodologjia ÇIP, e cila bazohet në kryqëzimin e të dhënave të botimit mes të paktën dy burimeve zyrtare ku publikohen akte, njeh limitimet e veta objektive. Çdo pohim mbi natyrën/llojin e këtyre 112 VKM-ve do ishte një spekulim në këtë pikë; e shumta, një pohim i tillë mund të ketë vetëm karakter *sasior* dhe jo *cilësor*.

Në **grafikun 1**, këto 112 VKM të *paidentifikueshme konkretisht* grupohen në **Zonën Gri**. VKM-të e grupuar në këtë zonë, përfaqësojnë ato akte për të cilat ka dijeni vetëm Qeveria, ose e thënë ndryshe, janë të panjohura për shqiptarët e zakonshëm. Vlerat numerike mbi të cilat janë përllogaritur përqindjet në grafik jepen edhe njëherë të grupuara në **tabelën legjendë** në fund të faqes.



⁴ Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës. (Neni 81/1 i Kushtetutës)

⁵ 68 janë projektligjet që KM ka listuar në nënkategorinë: akte të qeverisë/projektligje (www.keshilliministrave.al/?fq=preprog/projektligje), kurse një tjetër VKM për propozim projektligji gjendet e listuar tek: akte të qeverisë/vendime të këshillit të ministrave: www.keshilliministrave.al/?fq=preprog/VKM, dhe konkretisht kjo VKM është: *vendim për propozimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet këshillit të ministrave të republikës së shqipërisë dhe komisionit të komuniteteve europiane, Për programin e financimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë..."*





LEGJITIMITETI I MONITORIMIT

Udhëzime të KM dhe ministrave

Udhëzimi është një akt me karakter normativ që detajon, sygjeron dhe këshillon, nëpërmjet orientimeve të shtjelluara e të zbërthyer me hollësi, të gjitha urdhërimet që ka vendosur ligji. Udhëzimi ka karakter sqarues, por kjo nuk duhet marrë dhe as interpretuar në kuptimin e ngushtë të emërimit të tij, sikur ai nuk mund të sjellë efekte detyruese për subjektet e së Drejtës Administrative. Organet përkatëse të administratës si dhe personat të cilëve iu drejtohet udhëzimi, janë të detyruar të zbatojnë me përpikmëri rregullat që ai vendos për marrëdhënien konkrete që parashikon. Sigurisht që, efektet detyruese të normave të udhëzimit nuk janë të së njëjtës shkallë me normat juridike të vendimit, urdhëresës ose rregullores. Megjithatë, normat juridike që parashikon udhëzimi janë norma të një akti juridik dhe si të tilla, mbeten të detyrueshme për t'u zbatuar¹. E drejta për të nxjerrë udhëzim i përket vetëm organit që i është njohur shprehimisht një e drejtë e tillë. Sipas Kushtetutës (neni 100/5 & 102/4), udhëzimi nxirret vetëm nga Këshilli i Ministrave dhe ministri². Për shkak të karakterit të tij normativ, udhëzimi hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare, konform përcaktimit të nenit 117 të Kushtetutës sipas të cilit “Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare”.

Në respekt të normës kushtetuese, Ligji Nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, përcakton qartë përmes nenit 29, pika 3, se: “Udhëzimet e Këshillit të Ministrave dhe të

ministrit marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

Botimi i akteve normative që nxjerrin Këshilli i Ministrave dhe ministrat është gjithashtu detyrim ligjor për QPZ. Neni 2, gërma “a” e ligjit nr.8502, datë 30.6.1999, i ndryshuar, “Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare”, përcakton shprehimisht detyrimin e Qendrës për botimin e “akteve normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore...”.

Nga i gjithë parashtrimi i mësipërm, është e qartë se botimi në FZ i udhëzimeve të KM dhe ministrave, është një detyrim ligjor (ligji 9000 dhe ligji 8502). Në kuadër të këtij monitorimi do të paraqiten gjetjet për udhëzimet që nxirren nga:

1. Këshilli i Ministrave
2. Ministria e Financave
3. Ministria e Arsimit
4. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
5. Ministria e Bujqësisë
6. Ministria e Mjedisit
7. Ministria e Drejtësisë
8. Ministria e Brendshme
9. Ministria e Ekonomisë
10. Ministria e Shëndetësisë
11. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale...

Udhëzimet e përbashkëta do të përlllogariten vetëm kur rezulton se kanë sistem të qartë indeksimi.

Neni 29

Hyrja në fuqi e akteve

1. Aktet normative, me fuqinë e ligjit, të Këshillit të Ministrave botohen menjëherë në Fletoren Zyrtare.

2. Vendimet e Këshillit të Ministrave marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare. Për vendimet me karakter normativ mund të caktohet si datë hyrjeje në fuqi një datë tjetër nga ajo e botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi menjëherë, por botohen në Fletoren Zyrtare.

3. Udhëzimet e Këshillit të Ministrave dhe të ministrit marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare.

4. Organet e Kryeministrit, të ministrit ose të drejtuesit të institucionit qendror, në varësi të Kryeministrit ose të ministrit, hyjnë në fuqi menjëherë, u njoftohen të interesuarve dhe shpallen, për të paktën 3 ditë, në një vend të dukshëm të institucionit përkatës.

Neni 29, paragrafi 3, ligji 9000, dt. 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”.

1 “E Drejta Administrative 2” Sokol Sadushi, botimi i tretë i ripunuar, 2005, fq.61
2 “E Drejta Administrative 2” Sokol Sadushi, botimi i tretë i ripunuar, 2005, fq.62





REZULTATET E MONITORIMIT, 2010

Udhëzime të Këshillit të Ministrave (KM)

Këshilli i Ministrave nxjerr çdo vit një numër relativisht të ulët udhëzimesh, të cilat indeksohen, sikurse dhe VKM-të, nga një varg numerik rritës me bazë kalendarike.

Kjo do të thotë se seria e udhëzimeve që nxjerr KM hapet në fillim të çdo viti me numrin indeksues 1 dhe

mbyllet nga numri rendor që merr udhëzimi i fundit për atë vit (deri më 31 dhjetor).

Nga hulumtimi i të gjitha Fletoreve Zyrtare 2010, rezultojnë të jenë botuar gjithsej 8 udhëzime të KM. Seria prej 8 udhëzimesh të KM për vitin 2010 hapet dhe mbyllet respektivisht me:

- ◆ **Udhëzim Nr 1, Datë 13-01-2010** - "Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësis mbi tokat bujqësore të ish-NB-ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin".
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 4, Faqe 59; Data e botimit: 28-01-2010)

- ◆ **Udhëzim Nr 8, Datë 10-12-2010** - "Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave të dhënies të së drejtës subjekteve juridike, për marrjen, në dispozicion, të sipërfaqeve të parashikuara për ndërtimin e objekteve e zhvillimin e veprimtarisë përkatëse në zonën energjetike dhe industriale, të Porto-Romanos, Durrës".
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 181, Faqe 10144; Data e botimit: dhjetor 2010)

Nuk rezultojnë të dhëna (në faqen zyrtare të internetit të KM, në raporte, strategji, etj.) që të indikojnë ekzistencën e ndonjë udhëzimi tjetër që do të kishte numër indeksues më të madh se "8", çka do të influenconte rezultatin e verifikimit. Po ashtu, nuk u has as në ndonjë udhëzim të KM me numër indeksues të fraksionuar (shih: Shkurt mbi Metodologjinë "ÇIP").

Vlen të theksohet se në faqen zyrtare në internet të KM gjenden të publikuara vetëm 6 udhëzime nga 8 gjithsej të nxjerra në vitin 2010. Sigurisht, kjo është një e dhënë që nuk e zbeh faktin se KM dhe QPZ kanë respektuar plotësisht detyrimet ligjore që burojnë nga ligjet përkatëse (ligji 9000 dhe ligji 8502), në rastin konkret për të botuar udhëzimet e KM në Fletore Zyrtare.

*Si konkluzion,
mund të thuhet se:*

gjatë vitit 2010, janë botuar në Fletore Zyrtare të gjitha udhëzimet e Këshillit të Ministrave





REZULTATET E MONITORIMIT, 2010

Udhëzime të Ministrisë së Financave (MF)

Ministri i Financave nxjerr çdo vit një numër relativisht të lartë udhëzimesh, krahasuar me ministrat e tjerë të kabinetit qeveritar. Udhëzimet e Ministrisë së Financave, indeksohen, sikurse dhe VKM-të nga një varg numerik rritës me bazë kalendarike. Kjo do të

thotë se seria e aktit hapet në fillim të çdo viti me numrin indeksues 1 dhe mbyllet nga numri rendor që merr udhëzimi i fundit për atë vit (deri më 31 dhjetor). Seria e udhëzimeve të MF për vitin 2010 hapet dhe mbyllet respektivisht me:

- ◆ **Udhëzim Nr 1, Datë 21-01-2010** - "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2010".
(ky udhëzim nuk është i botuar në FZ, por i publikuar në faqen zyrtare të MF)
- ◆ **Udhëzim Nr.42, Datë 23-12-2010** - "Për disa ndryshime në udhëzimin Nr.1, dt. 08-01-2009 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive".
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 174, Faqe 8931; Data e botimit: 27-12-2010)

Nga hulumtimi i kujdesshëm, jo vetëm i Fletores Zyrtare 2010, por edhe i faqes zyrtare në internet të Ministrisë së Financave dhe i dokumentave të tjerë qeveritarë që gjenden online (raporte, strategji, etj) janë identifikuar konkretisht 4 udhëzime të nxjerra gjatë 2010-ës, të cilat kanë indeks të fraksionuar, konkretisht: 7/1; 7/2; 7/3; 9/1. Këto lloj udhëzimesh janë si rregull përmirësime apo ndryshime që i bëhen një udhëzimi konkret paraardhës, në rastin tonë atij me numër 7 dhe atij me numër 9. Kjo do të thotë se gjatë

vitit 2010-të, Ministria e Financave ka nxjerrë të paktën 46 udhëzime (42 udhëzime me indeks të thjeshtë + 4 udhëzime me indeks të fraksionuar), prej të cilave, në Fletore Zyrtare janë botuar vetëm 30.

Në tabelën me kutiza, jepet një paraqitje vizive e mungesave që konstatohen në botimin e këtyre udhëzimeve në Fletoren Zyrtare 2010. Në këtë tabelë janë të renditura edhe 5 udhëzime të përbashkëta të MF me institucione të tjera (shih referencat në fund të faqes).

1	2	3	4 ¹	5	6	7	7/1	7/2	7/3
8	9	9/1	10	11	12	13	14	15	16
17 ²	18	19	20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31 ³	32	33	34	35	36 ⁴
37	38	39	40	41	42 ⁵				

Me portokalli janë ngjyrosur kutizat të cilat indikojnë udhëzime që nuk janë botuar në FZ. Me të verdhë janë ngjyrosur kutizat që indikojnë ato udhëzime që nuk janë botuar në FZ, të cilat janë identifikuar nga ÇIP si titull dhe/ose si përmbajtje. (shih: Tabela Nr.1, fq 27).

Si konkluzion, ashtu sikurse sugjerojnë edhe kutizat e ngjyrosura,

në Fletore Zyrtare 2010-të, nuk janë botuar të paktën 14 udhëzime të MF ose 30% e totalit

1 Udhëzim i përbashkët me MB
2 Udhëzim i përbashkët me MASH
3 Udhëzim i përbashkët me MPPT, MITIK
4 Udhëzim i përbashkët me MPPT
5 Udhëzim i përbashkët me RTSH





REZULTATET E MONITORIMIT, 2010

Udhëzime të Ministrisë së Arsimit (MASH)

Edhe ministri i Arsimit dhe Shkencës, ashtu sikurse ai i Financave nxjerr një numër relativisht të lartë udhëzimesh brenda harkut kohor të një viti, krahasuar me ministrinë e tjera. Udhëzimet e MASH, indeksohen gjithashtu, nga një varg numerik rritës me bazë

kalendarike. Fletorja Zyrtare, 2010 sugjeron se seria e udhëzimeve të MASH për këtë vit hapet dhe mbyllet respektivisht me:

- ◆ **Udhëzim Nr 1, Datë 04-01-2010** - "Për rishpërndarjen e kuotave të përcaktuara dhe regjistrimin e pranimeve për plotësimin e kuotave në ciklin e parë të studimeve, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2009-2010".

(botuar në Fletore Zyrtare Nr 26, Faqe 799; Data e botimit: 21-03-2010)

- ◆ **Udhëzim Nr 38, Datë 02-12-2010** - "Për një ndryshim në udhëzimin nr 35, dt 05/11/2010 "Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë, të studimeve me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2010-2011"

(botuar në Fletore Zyrtare Nr 187, Faqe 10366; Data e botimit: 25-02-2011)

Në Fletore Zyrtare, 2010 rezultojnë të botuara *de-facto* vetëm 24 udhëzime të MASH. Nga hulumtimi i ku-jdesshëm i FZ, faqes në internetit të MASH, por dhe i dokumenteve të tjerë qeveritarë online, nuk rezulton të jetë nxjerrë gjatë këtij viti ndonjë udhëzim me indeks të fraksionuar, apo me numër indeksues më të madh se "38". Kjo sugjeron se në FZ nuk janë të botuara 14 udhëzime të MASH të nxjerra gjatë 2010-ës.

ÇIP ka identifikuar konkretisht 2 udhëzime të nxjerra gjatë 2010-ës, të cilat janë pjesë e këtij stoku prej 12 udhëzimesh të pabotuara në Fletore Zyrtare.

Në tabelën me kutiza, jepet një paraqitje vizive e mungesave që konstatohen në vargun indeksues të udhëzimeve të MASH.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
31	32	33	34	35	36	37	38		

Me portokalli janë ngjyrosur kutizat të cilat indikojnë udhëzime që nuk janë botuar në Fletore Zyrtare.

Me të verdhë janë ngjyrosur kutizat që indikojnë ato udhëzime që nuk janë botuar, të cilat janë identifikuar nga ÇIP si titull dhe/ose si përmbajtje. (shih: Tab 1, fq 27) .

Si konkluzion, siç sugjerojnë edhe kutizat e ngjyrosura,

në Fletore Zyrtare 2010-të, nuk janë botuar të paktën 14 udhëzime të MASH ose 37% e totalit





REZULTATET E MONITORIMIT, 2010

Udhëzime të Ministrisë së Transporteve (MPPT)

Ministria e Punëve Publike, Transportit, MPPT nxjerr një numër relativisht të vogël udhëzimesh brenda një viti. Udhëzimet e kësaj ministrie indeksohen gjithashtu, nga një varg numerik rritës me bazë kalendarike. Kjo do të thotë se seria e aktit hapet në

fillim të çdo viti me numrin indeksues 1 dhe mbyllet nga numri rendor që merr udhëzimi i fundit për atë vit (deri më 31 dhjetor). Nga shqyrtimi i Fletores Zyrtare 2010 rezulton se udhëzimi me numrin më madh në vargun indeksues është:

- ◆ **Udhëzimi Nr.27, Datë 07-10-2010** - "Për një ndryshim në udhëzimin Nr 40, datë 24-12-2008 "Për caktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë"
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 147, Faqe 7906; Data e botimit: 06-11-2010)

Në Fletore Zyrtare, 2010 gjendet i botuar një udhëzim i kësaj ministrie me indeks të fraksionuar, nr. 13/1. Ndërkohë, nuk rezulton që kjo ministri të ketë nxjerrë ndonjë udhëzim me numër indeksues më të madh se "27" gjatë vitit 2010 (edhe pse kjo nuk përjashtohet teorikisht).

Kjo do të thotë se gjatë 2010-ës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit ka nxjerrë të paktën 28 udhëzime (27 udhëzime me indeks të thjeshtë + 1 ud-

hëzim me indeks të fraksionuar). *De facto* gjenden të botuara në Fletore Zyrtare 2010 vetëm 22 udhëzime.

Nga 6 udhëzime të lëna jashtë botimi në FZ, janë identifikuar konkretisht 3 prej tyre (shih: Tabela nr. 1).

Në tabelën me kutiza, jepet një paraqitje vizive e mungesave në botim që konstatohen për udhëzimet e MPPT gjatë 2010-ës.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	13/1	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26	27		

Me portokalli - kutizat, që indikojnë udhëzime që nuk janë botuar në Fletore Zyrtare.

Me të verdhë - kutizat që indikojnë udhëzime që nuk janë botuar në FZ, por të identifikuar nga ÇIP si titull dhe si përmbajtje (shih: Tab Nr.1, fq 27).

Si konkluzion, ashtu sikurse sugjerojnë dhe kutizat e ngjyrosura,,

në Fletore Zyrtare 2010, nuk janë botuar të paktën 6 udhëzime të MPPT ose 21% e totalit





REZULTATET E MONITORIMIT, 2010

Udhëzime të Ministrisë së Mjedisit (MMPAU)

Ministria e Mjedisit, Mbrojtjes së Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) nxjerr një numër të vogël udhëzimesh brenda një viti. Udhëzimet e kësaj ministrie indeksohen gjithashtu, nga një varg numerik rritës me bazë kalendarike. Kjo do të thotë se seria e

aktit hapet në fillim të çdo viti me numrin indeksues 1 dhe mbyllet nga numri rendor që merr udhëzimi i fundit për atë vit (deri më 31 dhjetor). Nga hulumtimi një për një i të gjitha Fletoreve Zyrtare 2010, gjendet të botuara *de-facto* vetëm një udhëzim, konkretisht:

- ◆ **Udhëzim Nr 2, Datë 29-06-2010** - "Për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore".
(botuar në Fletore Zyrtare Nr110, Faqe 5452; Data e botimit: 19-08-2010)
- ◆ **Udhëzim Nr.5, Datë 26-11-2010** - "Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis".
(botuar në Fletore Zyrtare Nr 174, Faqe 8928; Data e botimit: 27-12-2010)

Ministria e Mjedisit në datën 28-12-2010 ka nxjerrë një udhëzim që nuk indeksohet në varg numerik standart, por në një mënyrë të pa njohur nga ne. Ky udhëzim ka nr. 1065. Ndërkohë MMPAU ka nxjerrë dy udhëzime të cilat janë indeksuar me numrin "3", edhe pse janë të ndrëshëm si për nga data ashtu dhe nga përmbajtja. Njëri prej këtyre udhëzimeve është i pëbashkët me Ministrinë e Brendshme, MB, dhe konkretisht:

Udhëzimi Nr 3, Datë 16.8.2010 - "Për rregullat dhe procedurat e pajisjes së shtetasve të huaj, rezidentë dhe jorezidentë, me leje gjëtie".

Meqenëse ky udhëzim rezulton të jetë i iniciuar nga

MMPAU, atëherë ky do të përlllogaritet në vlerësimin që i bëhet totalit të udhëzimeve të botuar në Fletore Zyrtare 2010 nga kjo ministri. Ky total konsiston në 7 udhëzime gjithsej (me gjithë udhëzimin nr. 1065)

Tek Ministria e Mjedisit (MMPAU) vihet re thujse në çdo vit kalendarik fenomeni që udhëzime të ndryshme si për nga data si për nga përmbajtja kanë (marrin) numër të njëjtë indeksues.

1	2	3	3	4	5	1065
---	---	---	---	---	---	------

Në tabelë me kutiza, me portokalli janë ngjyrosur ato indekse të cilat i përkasin udhëzimeve të pa-botuara në FZ.

Si konkluzion, ashtu sikurse sugjerojnë dhe kutizat e ngjyrosura,

në Fletore Zyrtare 2010, nuk është botuar të paktën 1 udhëzim i MMPAU ose 14 % e totalit





REZULTATET E MONITORIMIT, 2010

Udhëzime të Ministrisë së Bujqësisë (MBUMK)

Ministria e Bujqësisë, Ushqimi dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, gjatë një vit nxjerr një numër të vogël udhëzimesh, të cilat indeksohen nga një varg numerik rritës me bazë kalendarike. Nga hulum-

timi një për një i të gjitha Fletoreve Zyrtare 2010-të, gjendet i botuar vetëm një udhëzim i MBUMK, konkretisht ai me nr. 1, i cili hap edhe vargun indeksues për vitin 2010:

- ◆ **Udhëzim Nr 1, Datë 14-01-2010** - "Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.1290, datë 23.12.2009, "Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masave të përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural".

(botuar në Fletore Zyrtare Nr. 14, Faqe 442; Data e botimit: 25-02-2010)

Nga shqyrtimi i burimeve zyrtare në internet, rezulton se në datën 17. 11. 2010, Ministri i Bujqësisë ka firmosur udhëzimin nr. 19, "**Për metodat e marrjes së mostrave dhe analizimit për kontrollin zyrtar të nivelit të nitrates në produktet ushqimore**". Ky udhëzim sugjeron se, gjatë vitit 2010, titullari i MBUMK, ka nxjerrë të paktën 19 udhëzime.

Kërkimi në dokumenta të tjera zyrtare, nuk hasi në ekzistencën e ndonjë udhëzimi të MBUMK me numër të fraksionuar, apo me numër më të lartë se "19" (edhe pse kjo nuk mund të përjashtohet aspak teorikisht). Në tabelën me kutiza, jepet një paraqitje vizuale e mungesave në botim që konstatohen për udhëzimet e MBUMK gjatë 2010-ës.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17	18	19	

Me portokalli: udhëzime që nuk janë botuar në FZ.

Me të verdhë: udhëzime të pabotuara në FZ, por të identifikuar nga ÇIP edhe si përmbajtje (Tab Nr.1, fq 27).

Megjithë kufizimin metodologjik në këtë rast, si konkluzion mund të thuhet se:

në Fletore Zyrtare 2010-të, nuk janë botuar të paktën 18 udhëzime të MBUMK ose 95 % e totalit



SHËNIM METODOLOGJIK:

Ministritë që vijojnë më poshtë, përdorin një sistem të ndryshëm “indeksimi” për udhëzimet që nxjerrin. Në fakt, më tepër sesa indekse aktesh, ato mund të konsiderohen numra të cilat “pagëzojnë” udhëzimin jashtë ndonjë rregulli të njohur. Nuk përjashtohet në ndonjë rast mundësia që, numri indeksues të jetë i prejardhur nga vitet pararendëse, ose të jetë me bazë protokollit. Kjo e bën të pamundur vlerësimin e rregullsisë së vargut indeksues, element bazë mbi të cilin mbështetet metoda monitorues ÇIP.

Në pamundësi për të hulumtuar vargun indeksues me bazë kalendarike, nga ku do të mund të identifikoheshin edhe mungesat eventuale të botimit në Fletore Zyrtare, ÇIP do të kufizohet

vetëm në aplikimin e hallkës Faktike të verifikimit. E thënë ndryshe, përmes shqyrtimit të faqeve zyrtare, dokumentave qeveritare (raporte vjetore, strategji etj.) do të synohet identifikimi i atyre udhëzimeve që nuk figurojnë të botuara në Fletore Zyrtare.

Meqë faqet zyrtare në internet të këtyre ministrive nuk publikojnë udhëzime (me përjashtime të rralla), atëherë rezultatet e monitorimit për këto ministri do të konsiderohen “të brishta” nga pikëpamja metodologjike. Pavarësisht kësaj, gjetjet për udhëzimet e lëna jashtë botimit në Fletore Zyrtare për këto ministri, nuk mund të jenë në asnjë rast më të vogla se ato që do të reklamohen më poshtë; përkundrazi, ato në çdo rast janë teorikisht më të mëdha.



Udhëzime të Ministrisë së Brendshme (MB)

Pas shfletimit një për një të të gjitha Fletoreve Zyrtare 2010, rezultojnë të botuara 5 udhëzime të Ministrisë së Brendshme dhe një udhëzim i përbashkët i MB me MPPT (nr 56881)

Në burimet zyrtare alternative të shfletuara në kuadër të këtij monitorimi janë gjetur dhe 3 udhëzime të MB të cilat rezultojnë të pabotuara në Fletore Zyrtare, konkretisht:

- ◆ **Udhëzim Nr 30, Datë 05-02-2010** “Për veprimin e përbashkët antitrafikim”,
- ◆ **Udhëzim Nr 359, Datë 11-10-2010** “Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve Shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile”,
- ◆ **Udhëzim Nr 365, Datë 14-10-2010** “Për hartimin e listave përfundimtare të zgjedhësve”.

Dy prej këtyre udhëzimeve u hasen të përmendura në *Raportin për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore*, Janar – Dhjetor 2010. (publikuar në: www.dsdc.gov.al)

Bie në sy se dy nga udhëzimet e pabotuara janë akte të rëndësishme për listat zgjedhore në Republikën e Shqipërisë për Zgjedhjet Vendore të 8 Majit 2011.

Si konkluzion mund të thuhet se,

u identifikuan të paktën 3 udhëzime të MB të pabotuara në Fletore Zyrtare 2010





Udhëzime të Ministrisë së Drejtësisë (MD)

Nga humultimi një për një i të gjitha Fletoreve Zyrtare 2010, rezultojnë të botuara 4 udhëzime të Ministrisë së Drejtësisë. Dy prej tyre janë të përbashkët me institucione të tjera, konkretisht **udhëzimi Nr. 2007/1**, datë 02.03.2010, është i përbashkët me Ministrinë e Ekonomisë kurse **udhëzimi Nr. 5**, datë 21.07.2010, i

është përbashkët me Prokurorinë e Përgjithshme.

Nga kërkimi në burimet alternative zyrtare ku publikohen akte, nuk u gjend ndonjë udhëzim tjetër i kësaj Ministrie, që do të rezultonte i lënë jashtë botimit në Fletore Zyrtare 2010.



Udhëzime të Ministrisë së Punës (MPÇSSHB)

Pas shfletimit të të gjitha Fletoreve Zyrtare 2010, rezultojnë të botuara 11 udhëzime të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, MPÇSSHB.

Nga kërkimi në faqen zyrtare të internetit të kësaj Ministrie, apo burimet alternative zyrtare ku publikohen akte, nuk u gjend ndonjë udhëzim i cili të rezultonte i lënë jashtë botimit në Fletore Zyrtare 2010.



Udhëzime të Ministrisë së Ekonomisë (METE)

Nga humultimi i të gjitha Fletoreve Zyrtare 2010, rezultuan të botuara 6 udhëzime të Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës. Dy prej këtyre udhëzimeve janë me numër indeksues të fraksionuar (1/1 dhe 1/2). Ndërkohë, u gjendën edhe dy udhëzime të përbashkëta të kësaj ministrie me ME, konkretisht ai me nr, 1 dhe nr. 10280 (pra, ka dy udhëzime me

numër indeksues "1": njëri prej tyre është i përbashkët me ME, kurse tjetri i METE).

Nga kërkimi në faqen zyrtare të internetit të kësaj Ministrie, apo burimet alternative zyrtare ku publikohen akte, nuk u gjend ndonjë udhëzim i cili të rezultonte i lënë jashtë botimit në Fletore Zyrtare 2010.



Udhëzime të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH)

Nga hulumtim i kujdesshëm i Fletores Zyrtare 2010, nuk u gjend i botuar asnjë udhëzim i Ministrisë së Shëndetësisë. Ndërkohë, shtypi i përditshëm, ka shkruar (referuar) për disa udhëzime të MSH, konkretisht: *Udhëzim "Për organizimin e sesioneve të dhurimit vullnetar të gjakut nga personeli i institucioneve shëndetësore*

në të gjithë vendin". Atributete e një akti të tillë nuk janë gjetur dot në asnjë nga burimet e mundshme që konsultohen në kuadër të këtij monitorimi. Rrjedhimisht, për skrupulozitet metodologjik (shtypi nuk konsiderohet burim zyrtar), udhëzimi në fjalë nuk mund të reklamohet si i pabotuar.



TABELA nr.1

Nr.	Udhëzime të identifikuara konkretisht (si titull dhe/ose si përmbajtje) të cilat nuk gjenden të botuara në Fletore Zyrtare, 2010	Indeksi i udhëzimit	Emri i ministrisë	Data e udhëzimit
1	Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2010	1	MF	21-01-2010
2	Për përgatitjen e Buxhetit të shtetit dhe fondet speciale	7	MF	22-02-2010
3	Për përgatitjen e Buxhetit të shtetit dhe fondet speciale	7/2	MF	09-07-2010
4	Për përgatitjen e Buxhetit vendor	7/3	MF	10-07-2010
5	Për masat për zhvillimin provimeve të lirim të provimeve të Maturës Shtetërore 2010	12	MASH	05-04-2010
6	Për shitjen e tekstit në arsimin parauniversitar	15	MASH	28-05-2010
7	Për përcaktimin e kriterëve, masës dhe procedurave për përfituesit nga fondi i ekselencës për studentët dhe shkencëtarët e rinj, të shkëlqyer.	24	MASH	30-07-2010
8	Për pranimet në shkollat e mesme të përgjithshme me kohë të shkurtuar dhe me korrespondencë, organizimin dhe njëvlershmërinë e tyre.	37	MASH	22-11-2010
9	Për përcaktimin e një përkufizimi të përbashkët të pjesëve kritike të zonave kufizuese të sigurisë në aeroporte.	24	MPPTT	20-10-2010
10	Për vendosjen e masave për implementimin e standarteve të përgjithshme bazë për sigurinë në aeroporte	25	MPPTT	20-10-2010
11	Për rregullat e përgjithshme të sigurisë së avionëve civil.	26	MPPTT	20-10-2010
12	Për dokumentacionin e verifikimit të tokave bujqësore të pakultivuara.	8	MBUMK	18-06-2010
13	Për metodat e marrjes së mostrave për kontrollin zyrtar të niveleve të mykotoksinave në produktet ushqimore	12	MBUMK	29-09-2010
14	Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore	13	MBUMK	29-09-2010
15	Për limitet maksimale të mbetjeve të produkteve mjekësore veterinarë në produktet ushqimore me origjinë shtazore	15	MBUMK	15-10-2010
16	Për aditivët ushqimorë	18	MBUMK	17-11-2010
17	"Për metodat e marrjes së mostrave dhe analizimit për kontrollin zyrtar të nivelit të nitrave në produktet ushqimore"	19	MBUMK	17-11-2010
18	Për veprimin e përbashkët të strukturave zbatuese të "Strategjisë Kombëtare për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore"	30	MB	05-02-2010
19	Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltar dhe nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile	359	MB	11-10-2010
20	Për hartimin e listave përfundimtare të zgjedhësve.	365	MB	14-10-2010



PUSHTETI GJYQËSOR

Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor (neni 7 i Kushtetutës).

Pushteti gjyqësor garanton mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e normave kryesore të vendosura, me qëllim që të realizojë zhvillimin e një jete të rregullt sociale. Në Republikën e Shqipërisë, Pushteti Gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, nga Gjykatat e Apelit si dhe ato të Shkallës së Parë (neni 135 i Kushtetutës).

Ligji organik nr 8436, dt 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” rregullon në tërësi organizimin e drejtësisë bazuar në Kushtetutën e vendit, kurse aktiviteti i Gjykatës së Lartë rregullohet me ligj organik të veçantë, konkretisht, ligji nr.8588 dt.15/03/2000 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të R.Sh.”

Një nga funksionet më të rëndësishme të Gjykatës së Lartë është edhe unifikimi i praktikës gjyqësore në Republikën e Shqipërisë. Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, ajo tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore. Vendimet e Gjykatës së Lartë janë të detyrueshme për t'u ekzekutuar.

Ligji nr.8588 dt.15/03/2000 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të R.Sh.”, i ka kushtuar një rëndësi të veçantë shpalljes dhe botimit të vendimeve të kësaj gjykate. Neni 19 i ligjit në fjalë, përcakton shprehimisht se:

1. *Vendimet e Gjykatës së Lartë shpallen të arsyetuara jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor.*
2. *Vendimet e kolegjeve të Gjykatës së Lartë, së bashku me mendimet e pakicës, botohen në Buletinin Periodik të Gjykatës së Lartë.*
3. *Vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.*

Ligjvënësi ka përcaktuar qartë dhe prerë në pikën 3 të nenit 19 detyrimin për botimin në Fletoren Zyrtare më të parë të vendimeve për njësimin dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore (vendimet unifikuese të GJL).

Ky nen përmban një detyrim të dyfishtë: përveçse duhet botuar në Fletore Zyrtare, kjo duhet bërë edhe në kohën më të shpejtë të mundshme (në numrin më të parë të Fletores Zyrtare). Respektimi i modaliteteve të publikimit të vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë garanton interpretimin dhe zbatimin uniform të ligjeve, në respekt të parimit të sigurisë ligjore.

Përmes vendimeve që japin Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sigurohet uniformitet në interpretimin e ligjeve në procesin gjyqësor prej të gjithë trupës së gjyqtarëve (rreth 350). Mosbotimi i tyre në Fletore Zyrtare do të shkaktonte *apriori* mos-përm-bushjen e qëllimit të synuar për unifikim të praktikës gjyqësore.

Nga ana tjetër, arsyeja se përse ligjvënësi ka përcaktuar që këto lloj vendimesh duhet të botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare, ka të bëjë me faktin se ato duhet të njihen sa më shpejt që të jetë e mundur nga trupa gjyqësore e gjykatave më të ulta, me qëllim që praktika, tashmë e unifikuar përmes interpretimit ligjor të Gjykatës së Lartë, të reflektohet në kohën e duhur në çështjet relevante në shqyrtim apo që do të shqyrtohen prej tyre.

Bazuar në parashtrimet e mësipërme, vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, në kuadër të këtij monitorimi do të vlerësohen si në *terma të botimit*, ashtu edhe në *terma kohorë* të botimit të tyre në FZ. Ekipi monitorues ka evidentuar Fletoren Zyrtare ku gjendet i botuar vendimi unifikues i GJL si dhe ka përllogatur në mënyrë të përafërt se cila do të duhej të kishte qenë Fletorja Zyrtare “më e afërt” në të cilën do të duhej të botohej vendimi unifikues i GJL.



REZULTATET E MONITORIMIT, 2010

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë

Botimi në Fletore Zyrtare

Gjatë vitit 2010, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë dhënë vetëm një vendim unifikues, konkretisht: **Vendim Nr 1, dt. 26.11.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë**, me objekt "*Kundërshtim i aktit administrativ, vendimit nr.3550, datë 30.10.2009, për prishje objekti*" (burimi: websiti zyrtar i GJL).

Sipas nenit 19, pika 3 e ligjit 8588, "*Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të RSH*", vendimet unifikues botohen në numrin e pare të Fletores Zyrtare pasi

ato shpallen. Pas një shqyrtimi të kujdesshëm, nuk rezultoi që VUGJL nr. 1, dt. 26.11.2011 të jetë i botuar në serinë e Fletores Zyrtare 2010. Në fakt, vendimi në fjalë gjendet i botuar në FZ Extra Nr. 74, e cila ka dalë nga shtypshkronja në Prill 2011. Fletoret Zyrtare Extra, si rregull nxirren nga QPZ në vitin pasardhës. Në to botohen akte që nuk janë botuar dot në FZ (normale) brenda afateve ligjore që cakton ligji organik respektiv ose ligji 8502, datë 30.6.1999 "**Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare**", i ndryshuar.

Megjithatë, sa i takon detyrimin për botim të aktit, mund të thuhet se:

i vetmi Vendim Unifikues i GJL dhënë në 2010-ën, gjendet i botuar në Fletore Zyrtare

Afatet e botimit në Fletore Zyrtare

Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 1, dt. 26.11.2011 është botuar në Fletore Zyrtare me mjaft vonesë nga afati ligjor i parashikuar. Mesatarja e përlogaritur e vonesës është rreth 4 muaj.

Ritheksojmë edhe njëherë se neni 19, pika 3, ligji 8588 "*Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të RSH*" përcakton se: "*Vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore*

botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare". Nëse do të ishte respektuar kjo dispozitë, Fletorja Zyrtare ku duhej të botohej ky vendim duhet të kishte qenë ajo me nr. 157, e datës 30 Nëntor 2010.

Theksojmë se Fletorja Zyrtare e fundit për viti 2010 mban nr. 187 (*dalë nga botimi me dt. 25 Shkurt 2011*). Në fakt, ky VUGJL është botuar në Fletore Zyrtare Ekstra, (Prill 2011).

Si konkluzion mund të themi se,

i vetmi vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë në 2010-ën është botuar në Fletore Zyrtare me rreth 4 muaj vonesë nga afati që përcakton ligji 8588



GJYKATA KUSHTETUESE

E dhe pse në kuadër të këtij studimi, botimi i akteve të Gjykatës Kushtetuese trajtohet pas kapitullit për Gjyqësorin, vetë kjo gjykatë nuk bën pjesë në sistemin gjyqësor të zakonshëm. Ajo ka një juridiksion të veçantë për kontrollin e kushtetueshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjerë normativë. Gjykatat Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj (neni 124/1 i Kushtetutës). Gjatë ushtrimit të funksionit të saj ajo i nënshtrohet vetëm Kushtetutës (neni 124/2 i Kushtetutës). Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese janë të parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës, sipas të cilit ky organ vendos për:

- papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122 të Kushtetutës;
- papajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre;
- papajtueshmërinë e akteve normativë të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;
- mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore;
- kushtetutshmërinë e partive dhe organizatave të tjera politike si dhe të veprimtarisë së tyre në bazë të nenit 9 të Kushtetutës;
- shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij;
- çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës dhe të deputetëve si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre;
- kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;
- gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shterrur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Organizimi dhe funksionimi i Gjykatës Kushtetuese rregullohet nga ligji organik nr. 8577, datë 10.2.2000. Sipas përcaktimit të nenit 2 të këtij ligji: “Gjykata Kushtetuese është autoriteti më i lartë që garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj”.

Duke qenë legjislator negativ *sui generis*¹, vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë rëndësi të veçantë. Ligji nr. 8577 i ka kushtuar një vëmendje të posaçme publikimit të këtyre vendimeve. Neni 26 i ligjit në fjalë përcakton se:

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare. Ato botohen në Fletoren Zyrtare dhe hyjnë në fuqi ditën e botimit të saj. Kur vendimi ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, Gjykata mund të vendosë që ai të hyjë në fuqi me shpalljen e tij.
2. Organi që boton Fletoren Zyrtare detyrohet të bëjë botimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, jo më vonë se 15 ditë nga ardhja për botim e tyre pranë atij organi.
3. Gjykata Kushtetuese çdo vit përgatit një përmbledhje të vendimeve të saj.

Përsa i takon afateve kohore të botimit të VGJK në Fletore Zyrtare, ligji organik nr. 8577, datë 10.2.2000. nuk vendos afat për vetë GJK se kur duhet ta dërgojë vendimin për botim në QPZ, por, nga ana tjetër cakton afat për këtë të fundit se kur duhet të realizojë botimin e VGJK, shprehimisht: “Jo më vonë se 15 ditë nga ardhja për botim e tyre pranë atij organi (QPZ).”

Ndërkohë, ligji nr. 8502, datë 30.6.1999 “Për krijimin e QPZ”, i ndryshuar, përcakton shprehimisht se: “Organi përgjegjës, sipas ligjit, është i detyruar të paraqesë për botim në QPZ aktet e parashikuara në shkronjën “a” të nenit 2 të këtij ligji, brenda 3 ditëve nga miratimi i tyre dhe, në raste të veçanta, jo më vonë se 15 ditë.” (Neni 6, ndryshuar me ligj nr.9091/2003).

Kjo do të thotë se, afati i lejuar ligjor, brenda të cilit duhet realizuar botimi në Fletore Zyrtare i VGJK është jo më shumë se 30 ditë, me përjashtim të rasteve kur GJK vendos vetë, që ai të hyjë në fuqi që me shpalljen e tij.

1 “E Drejta Kushtetuese” Luan Omari; Aurela Anastasi, ribotim 2010, fq. 418



REZULTATET E MONITORIMIT, 2010

Vendime të Gjykatës Kushtetuese

Botimi në Fletore Zyrtare

Gjatë vitit 2010, Gjykata Kushtetuese ka dhënë 38 vendime gjithsej (burimi: website zyrtar i GjK). Në Fletoren Zyrtare 2010 rezultojnë të jenë të botuar 38 vendime të Gjykatës Kushtetuese. *Si përfundim, mund të pohet se:*

gjatë vitit 2010, janë botuar në Fletore Zyrtare të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese të RSH

Afatet e botimit në Fletore Zyrtare

Përsa i takon afateve ligjore të botimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në Fletore Zyrtare nuk u identifikua asnjë rast vonese gjatë vitit 2010. Mënyra e përlogaritjes së afatit të botimit është shtjelluar në mënyrë të detajuar në parash-

trimin teorik për Gjykatën Kushtetuese, sipas të cilit afati i lejuar për botimin në Fletore Zyrtare të VGJK është jo më shumë se 30 ditë, me përjashtim të rasteve kur GJK vendos vetë, që ai të hyjë në fuqi që me shpalljen e tij.

Si konkluzion mund të thuhet se:

gjatë vitit 2010 nuk u konstatuan vonesa në botimin e Vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në Fletore Zyrtare



Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg

Shqipëria është vend anëtar i Këshillit të Europës. Shteti shqiptar ka nënshkruar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në 13/07/1995 dhe e ka ratifikuar atë në 2/10/1996, duke e bërë pjesë të sistemit të brendshëm ligjor (neni 17/2 e Kushtetutës).

Sipas përcaktimit të nenit 1 të KEDNJ, Shtetet Palë të saj (pra edhe Shqipëria), marrin përsipër detyrimin që të respektojnë, ndaj cilitdo që ndodhet nën juridiksionin tyre, të drejtat dhe liritë themelore të sanksionuara në Konventë (dhe në protokollet shtesë të saj).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Komiteti i Ministrave të KiE kontrollojnë përmbushjen nga Shtetet Palë, të detyrimeve të marra përsipër me ratifikimin e Konventës. Një nga këto detyrime është edhe ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ, proces i cili mbikqyret nga Komiteti i Ministrave.

Publikimi i vendimeve të GJEDNJ është pjesë e monitorimit të ekzekutimit të vendimeve prej Shtetit të Paditur ndaj të cilit Gjykata ka gjetur shkelje të Konventës. Ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ paraqet veçanti, po të shihet i krahasuar me një vendim gjyqësor të dhënë nga një gjykatë e zakonshme vendase. Vendimi i formës së prerë i dhënë nga Gjykata e Strasburgut ka dy komponentë kryesore: masat individuale dhe masat e përgjithshme. Publikimi i tekstit të plotë të vendimit të formës së prerë të Gjykatës është pjesë e ekzekutimit të masave të përgjithshme. Ai monitorohet në kuadër të implementimit të masave të përgjithshme nga ana e Komitetit të Ministrave në Takimet e të Drejtave të Njeriut, bazuar në raportimet që bëhen nga Shteti i Paditur që ka detyrimin e ekzekutimit të tyre.

Çdo Shtet Palë i Konventës karakterizohet nga një praktikë dhe traditë e veçantë në publikimin e vendimeve gjyqësore. Nisur nga rëndësia që marrin ven-

dimet e Gjykatës së Strasburgut (final judgements) përsa i përket jurisprudencës në fushën e të drejtave të njeriut, publikimi i këtyre vendimeve është i rëndësishëm jo vetëm në raport me çështjen ligjore konkrete, por edhe për unifikimin e praktikës së gjykatave vendase lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut. Unifikimi i kësaj praktike ka si qëllim parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në të ardhmen, të cilat do të mund të ishin objekt i aplikimeve të reja të cilat i drejtohen GJEDNJ.

Në vitin 2002, Komiteti i Ministrave i KiE ka hartuar Rekomandimin (2002)13, drejtuar Shteteve Palë të Konventës ku ndër të tjera kërkohet që të sigurohet publikim në gjuhën vendase dhe shpërndarje efektive e tekstit të Konventës si dhe e jurisprudencës së GJEDNJ, veçanërisht të asaj “që sjell një zhvillim të ri në interpretimin e neneve të Konventës”.

Botimi i tyre në Fletore Zyrtare është vlerësuar si një nga modelet i cili përmbush më së miri qëllimin e këtij Rekomandimi, por pa përjashtuar edhe nisma të ndryshme private. Shqipëria ka zgjedhur pikërisht publikimin në Fletore Zyrtare të tekstit të plotë të vendimeve të të gjitha çështjeve ku ajo ka qenë Shtet i Paditur.

Qendra ÇIP, ka përfshirë sërish në raportin e këtij viti rezultatet e monitorimi të botimit në Fletore Zyrtare të Vendimeve të GJEDNJ. Vlen të theksohet se, sikurse implikon edhe vetë termi “Rekomandim”, botimi i vendimeve të GJEDNJ nuk është një detyrim ligjor që buron nga sistemi i brendshëm juridik i Republikës së Shqipërisë.

Impakti i **vendimeve të formës së prerë** të GJEDNJ të dhëna ndaj Shqipërisë ka qenë i një rëndësie të veçantë për të drejtën e brendshme. Njohja e këtyre vendimeve përmes botimit në Fletoren Zyrtare i shërben më së miri garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri.



REZULTATET E MONITORIMIT, 2010

Vendime të GJEDNJ

Nga hulumtimi i të dhënave që ofron faqja zyrtare në internet e GJEDNJ (HUDOC Database), rezultoi se gjatë 2010 janë dhënë gjithsej 7 vendime, ku palë e paditur është Shqipëria. Prej këtyre, vetëm 3 marrin formë të prerë brenda harkut kohor të vitit 2010, kurse 4 të tjerat marrin formë të prerë në 2011, vit i cili del jashtë objektit kohor të këtij monitorimi. Ndërkohë, dy vendime të GJEDNJ të marra në vitin 2009, kanë marrë formë të prerë në vitin 2010 dhe konkretisht çështjet **"Bushati dhe të tjerë k. Shqipërisë"**, dhe **"Caka k. Shqipërisë"** (shih detajet në tabelën nr.1). Kjo do të thotë se objekt shqyrtimi sa i takon botimit në FZ të 2010, do të jenë vetëm 5 vendime të cilat kanë qenë të parashikuara të marrin

formë të prerë në 2010 (në **Tabelën nr. 2**, në fund të faqes janë pikërisht vendimet e renditura nga 1 deri në 5).

Nga hulumtimi rezultoi se të gjitha këto vendime janë të botuara në FZ 2010 (në gjuhën shqipe). Madje, çështja **"Bushati dhe të tjerë k. Shqipërisë"** (aplikimi nr. 6397/04), apo edhe **"Caka k. Shqipërisë"** (aplikimi nr. 44023/02) janë botuar në FZ para datës kur vendimi merrte formë të prerë. Këta janë gjithsesi tregues të një rregullsie të kënaqshme në botimin e vendimeve të GJEDNJ nga ana e Qeverisë Shqiptare.

Në tabelën Nr. 3 jepet një paraqitje e plotë e situatës së konstatuar sa i takon botimit në FZ të GJEDNJ.

Si përfundim mund të thuhet se:

në Fletore Zyrtare 2010 janë botuar të gjitha vendimet e GJEDNJ-së ku palë është Shqipëria

TABELA nr.2

Nr.	Çështja	Aplikim Nr.	Dt. e vendimit të GJEDNJ	Dt. kur merr formë të prerë	Botuar në
1	Bushati dhe të tjerë k. Shqipërisë	6397/04	8/12/2009	8/03/2010	FZ Ekstra nr. 39, 2009 (dalë me dt. 08/01/2010)
2	Caka k. Shqipërisë	44023/02	8/12/2009	8/03/2010	FZ Ekstra nr. 40, 2010
3	Mullai dhe të tjerë k. Shqipërisë	9074/07	23/03/2010	23/06/2010	FZ Ekstra nr. 41, 2010
4	Laska dhe Lika k. Shqipërisë	12315/04 dhe 17605/04	20/04/2010	20/07/2010	FZ Ekstra nr. 42, 2010
5	Berhani k. Shqipërisë	847/05	27/05/2010	04/11/2011	FZ Ekstra nr. 71, 2010
6	Puto dhe të tjerë k. Shqipërisë	609/07	20/07/2010	20/10/2010	F.Z Extra nr. 72, 2011
7	Vrioni dhe të tjerë k. Shqipërisë	35720/04 dhe 42832/06	07/12/2010	11/04/2011	FZ. Ekstra nr 75, 2011
8	Gjyli k. Shqipërisë	3290/07	07/12/2010	07/03/2011	F.Z Extra nr. 72, 2011
9	Mishgjonit k. Shqipërisë	18381/05	07/12/2010	07/03/2011	F.Z Extra nr. 72, 2011





PJESA E DYTË

BOTUESHMËRIA E AKTEVE, 2006-2010



Në Pjesën e Dytë të këtij publikimi ofrohet një panoramë e përgjithshme mbi situatën e botueshmërisë së akteve ligjore dhe nënligjore në Fletore Zyrtare gjatë pesë viteve të fundit (2006-2010). Në analizë janë përdorur të dhëna për secilin lloj akti që ka qenë objekt monitorimi nga ÇIP në kuadër të Raporteve të përvitshme “**Transparenca e Botimeve Zyrtare në RSH**”.

Të dhënat 5-vjeçare janë grupuar në tabela me vlera numerike për secilin akt dhe më pas janë përpunuar më tej në grafikë të posaçëm, të cilët ofrojnë një vizualizim të qartë të situatës së botueshmërisë për secilin akt dhe për secilin institucion, në harkun kohor të pesë viteve që janë në analizë (2006-2010).

Përlllogaritjet e **nivelit vjetor të botueshmërisë** së akteve janë bërë në përqindje, për të lehtësuar vlerësimet krahasuese në këtë drejtim. Po ashtu, në përqindje është përlllogaritur edhe niveli mesatar i botueshmërisë së aktit nga insititucioni për të pesta vitet të marra së bashku (2006-2010).

Nga rezultatet e botueshmërisë, ÇIP ka derivuar edhe **nivelin e zbatueshmërisë** të dispozitave të ligjeve organike që caktojnë detyrimin për botim në FZ të akteve që nxirren nga insititucioni që këto ligje normojnë. Ky derivat

synon të tregojë se në çfarë mase, vetë insititucione qëndrore kushtetuse i zbatojnë dispozitat e ligjit që rregullon organizimin dhe funksionimin e tyre (në rastin konkret nenet që caktojnë detyrimin për botim në FZ të akteve që ata vetë nxjerrin).

Grafikë të posaçëm janë përpunuar edhe për afatet kohore të botimit në FZ të VUGJL. Ky është një detyrim ligjor eksplicit që i caktohet Gjytës së Lartë nga neni 19/3 i ligjit organik nr.8588 dt.15/03/2000 “*Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të R.Sh.*”.

Një paraqitje grafike e veçantë është përzgjedhur edhe për të vizualizuar **trendin e botueshmërisë së aktit** për çdo vit që është objekt vlerësimi (2006-2010). Analiza e trendit (përkeqësues apo përmirësues), përveçse grafikisht, ofrohet edhe përmes shpjegimeve me fjalë. ÇIP ka bërë kujdes që këto shpjegime të jenë të kuptueshme dhe sa më konçize.

Metoda analitike e përdorur nga ÇIP për të realizuar të gjitha vlerësimet e mësipërme mund të shërbejë si model metodik përfaqëse edhe për aktorë të tjerë të interesuar në përlllogaritjen e nivelit të zbatimit të ligjeve dhe/ apo dispozitave të veçanta ligjore që paraqesin interes të posaçëm, të cilat janë objekt i punës së tyre monitoruese.



Mbi nivelin e zbatueshmërisë së dispozitave

Në kuadër të këtij studimi, kur flitet për “*nivel të zbatimit të dispozitave ligjore*”, nënkuptohen ato nene të Kushtetutës¹ apo të ligjeve organike të cilat caktojnë detyrimin për botim të akteve që nxjerr institucioni përkatës në Fletore Zyrtare. Kjo është me rëndësi të theksohet që në fillim, sa kohë që vetë procesi i botimit të akteve në FZ implikon një marrdhënie *dërgues-marrës (sender-receiver)*, respektivisht të institucionit që nxjerr aktin me Qendrën e Publikimeve Zyrtare, QPZ. Organizimi dhe veprimtarie e kësaj të fundit rregullohet me ligj të posaçëm, **nr. 8502, dt 29.6.1999, “Per krijimin e QPZ”, të ndryshuar**. Vlerësimi i zbatueshmërisë së dispozitave të këtij ligji nuk është objekt i kësaj analize, sa kohë që QPZ është “*institucion pritës*”.

Një arsye më shumë për t’u përqëndruar tek ligjet organike, konkretisht në dispozitat respektive që caktojnë detyrimin për botimin e akteve në FZ, është edhe fakti se ligjet organike kanë epërsi ndaj ligjeve të thjeshta, sikurse është në këtë rast ligji 8502.

Për më tepër, nuk ka të dhëna me karakter empirik që të sugjerojnë se akte të nxjerra nga institucionet qendrore kushtetuese janë lënë jashtë botimit në FZ nga vetë QPZ, për arsye që lidhen me organizimin dhe funksionimin e saj të brendshëm.

Është me rëndësi të theksohet se QPZ, pavarësisht se funksionon mbi bazën e një ligji të posaçëm, është në fund të fundit një institucion varësie (konkretisht i Ministrisë së Drejtësisë). Në këtë kuptim, gjasat logjike janë që insitucionet qendrore kushtetuese (dërguese) të diktojnë “fatin e botimit” të akteve që ato nxjerrin, më tepër sesa institucioni i varësisë (*marrësi*)².

Në tabelën e mëposhtme, jepet në mënyrë të detajuar një listë me ligjet organike, dispozitat e tyre që caktojnë botimin e akteve të nxjerra nga institucioni respektiv, të cilat do të jenë objekt vlerësimi sa i takon *nivelit të zbatueshmërisë*.

TABELA nr.3

Institucioni	Titulli i ligjit	Neni relevant	Loji i aktit
Kuvendi	Kushtetuta	84 & 117	Ligj
Këshilli i Ministrave	Ligji nr. 9000, dt. 30. 1. 2003 “Për organizimim dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”	29 (pika 1 & 2)	VKM, ANFL
Ministritë (përfshirë KM)	Ligji nr. 9000, dt. 30. 1. 2003 “Për organizimim dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”	29 (pika 3)	Udhëzim
Gjykata e Lartë	Ligji nr.8588 dt.15. 03. 2000 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të R.Sh.”,	19 (pika 3)	VUGJL
Gjykata Kushtetuese	Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të R.SH.”	26 (pika 1)	Vendim i GJK

1 Detyrimi për botimin e ligjeve në Fletore Zyrtare e cakton Kushtetuta. Në pjesën e tretë të Kushtetutës, kreu IV, nenin 84/3 thuhet se: “ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare”. Kjo është edhe procedura e zakonshme e hyrjes në fuqi të ligjit.

2 Për të bërë një vlerësim objektiv të performancës së QPZ në raport me botimin e akteve që ajo merr në dorëim nga institucionet qendrore kushtetuese është e domosdoshme kqyerja e hollësishme e regjistrat e saj, në të cilin regjistrohen aktet që ajo merr në dorëim për t’i procesuar më pas për botim.

ANALIZA E BOTUESHMËRISË 2006-2010


Ligjet e Kuvendit

Nga monitorimi i Fletoreve Zyrtare të nxjerra gjatë periudhës 2006 -2010, për llojin e aktit “**Ligj**”, nuk është konstatuar asnjë mungesë në botim. Në tabelën përmbledhëse, dhjetat ofrohet një paraqitjeje e totalit të ligjeve të miratuara nga Kuvendi dhe të botuara nga QPZ në Fletore Zyrtare për secilin vit, bazuar në të dhënat e raporteve të Transparencës së Botimeve Zyrtare në Republikës së Shqipërisë, që nga viti 2006 e deri në vitin 2010.

Viti	Totali i ligjeve të miratuara	Ligje të botuara në FZ	Ligje të pabotuara në FZ
2006	209	209	0
2007	184	184	0
2008	196	196	0
2009	157	157	0
2010	156	156	0

TABELA nr.4

Grafiku 1: Botueshmëria e aktit për çdo vit



Grafiku 2: Botueshmëria e aktit në pesë vite




Legjenda: ■ Të botuara ■ Të pabotuara

Botueshmëria vjetore e aktit: **Ligj**, në Fletore Zyrtare të çdo viti, për periudhën kohore 2006-2010 është 100% (Grafiku 1).

Në **Grafikun 2**, paraqitet **mesatarja e botueshmërisë** në Fletore Zyrtare të aktit: **Ligj** për të pestat vitet (2006-2010) të marra së bashku e cila është gjithashtu 100%. Ky grafik indikon njëkohësisht edhe nivelin e zbatueshmërisë së dispozitave relevante që caktojnë detyrimin për botim në FZ të aktit në fjalë (shih: tabela nr. 3). Nga 902 ligje gjithsej të miratuar gjatë kësaj periudhe 5-vjeçare, nuk ka asnjë që të mos jetë botuar në Fletoren Zyrtare të RSH.

Edhe **trendi i botueshmërisë** së aktit: **Ligj** që vizualizon **Grafiku 3** është një vijë e drejtë horizontale, e cila në boshtin vertikal qëndron në vlerën 100%.

Grafiku 3: Trendi i botueshmërisë së aktit



Mbi aktet e Këshillit të Ministrave

Këshilli i Ministrave (KM) është institucioni që nxjerr numrin më të madh të akteve brenda një viti krahasuar me çdo institucion tjetër qëndror. Shumica dërmuese e tyre janë *vendime*, ose sikurse njihen ndryshe, VKM.

Ai nxjerr herë pas here edhe *aktet normative me fuqinë e ligjit* (ANFL), të cilat përfaqësojnë një pjesë fare të vogël të totalit vjetor. Po ashtu, Këshilli i Ministrave nxjerr herë pas here edhe ndonjë udhëzim. Nisur nga numri relativisht i papërfillshëm krahasuar me VKM-të, identifikimit të ANFL apo udhëzimeve të lëna jashtë botimi është i thjeshtë dhe me mundësi gabimi në monitorim pothuajse "zero". Për më tepër, të dyja llojet e akteve në fjalë, janë me *natyrë përfundimtare* sa i takon efekteve që prodhojnë, rrjedhimisht, destinacioni i tyre final është FZ, sikundër është përcaktuar qartë në dispozitën 29/1 dhe 29/3 të ligjit 9000, dt. 30.1.2003 "*Për organizimin dhe funksionimin e KM*".

Kurse, procesi monitorues për llojin e *aktit*: VKM ndjek një protokoll relativisht të komplikuar. Kjo sepse jo të gjitha VKM-të kanë destinacion Fletore Zyrtare; një pjesë e tyre kanë *natyrë jo-përfundimtare (tranzitore)*. Konkretisht, Qeveria nxjerr VKM edhe kur *miraton në parim* çështje të caktuara (marrëveshje, lista me inventare pronash që i kalojnë në administrim pushteti vendor, etj.), apo edhe kur *propozon një projektligj*. Këta të fundit, fjala vjen, duhen ratifikuar nga Kuvendi dhe pastaj mund të dërgohen për botim në FZ (në këtë proces, VKM -ja "evoluon" në ligj). Pra, destinacioni final nuk është gjithmonë i njëjtë për aktet që nxjerr KM; ca janë *përfundimtare* dhe shkojnë për botim në FZ, ca të tjera janë *jo-përfundimtare* (tranzitore) që kalojnë për miratim të mëtejshëm në Kuvend, ose edhe nga vetë KM, i cili duhet të shprehet me një vendim përfundimtar mbi një çështje të caktuar (marrëveshje qeveritare, lista përfundimtare pronash, etj.).

Për më tepër, Këshilli i Ministrave nxjerr edhe VKM "*sekret*", të cilat, nga vetë përcaktimi, nuk botohen as në Fletore Zyrtare dhe as në faqen zyrtare të KM. Në rastin e VKM-ve "*sekret*", Metodologjia "ÇIP" nuk mund të aplikohet, duke hasur në këtë mënyrë limitet e veta.

Duhet theksuar gjithashtu se konsistenca e faqes së internetit të KM lë për të dëshiruar, duke ngushtuar në këtë mënyrë bazën krahasuese të të dhënave. Praktika e moni-

torimeve të përvitshme nga ÇIP ka provuar tashmë se një pjesë e VKM-ve që gjenden të botuar në Fletore Zyrtare, nuk janë fare të publikuara në faqen zyrtare në internetin të KM. Mospërputhjet e vërejtura në këtë drejtim për të pesta vitet, 2006-2010, jepen në mënyrë të detajuar në tabelën nr.6.

Për të gjithë arsyet e mësipërme, grafikët për botueshmërinë e *aktit*: VKM do të jenë ndryshe nga ata që janë përdorur për aktet e institucioneve të tjera në këtë studim. Kështu, objekt vizualizimi grafik do të jenë volumet e përvitshme të VKM-ve që dërgohen për botim në FZ që nga vit 2006 deri në vitin 2010 (thënë ndryshe, vlerat e pasqyruara janë rezultatet e *verifikimit Skematik*¹ për vitet në analizë, 2006-2010)

Një grafik i tillë nuk indikon domosdoshmërisht *botueshmërinë e aktit*: VKM (ose mos-botueshmërinë e tij); ai thjesht krijon një ide mbi përqindjen e VKM-ve që nuk dërgohen për botim në Fletore Zyrtare çdo vit në raport me totalin. Këto VKM të pabotuara, mund të jenë ose VKM "*sekret*", ose VKM "*për propozim projektligji*", ose VKM "*për miratim në parim*" ose VKM me *natyrë definitive (standarte)*, të cilat për arsye nga më të ndryshmet (detyrim ligjor, praktikë institucionale, harresë, neglizhencë, fshehje e qëllimshme) nuk janë dërguar për botim në FZ. Padyshim që, nga autorët do të interpretohej si një tregues pozitiv çdo rritje progresive (vit pas viti) e përqindjes së VKM-ve që dërgohen për botim në FZ krahasuar me ato që mbeten jashtë botimi çdo vit.

Një grafik tjetër do të jetë ai që do të paraqesë vëllimin që zenë VKM-të e tipeve të ndryshme në raport me njëra tjetrën për çdo vit në analizë (2006-2010). Ky grafik synon të demonstrojë përmes një analize diferencuese madhësinë reale të *Zonës Gri* ku grupohen të gjitha VKM-të e pabotuara, identifikimi itributeve (titull, datë, indeks) të të cilave është i pamundur përmes Metodologjisë "ÇIP". E thënë ndryshe, ky studim arrin të identifikojë *Zonën Gri* vetëm në terma sasiorë, pa diferencuar (vlerësuar) dot se cilat akte që gjenden brenda *Zonës Gri* duheshin botuar në FZ dhe cilat jo (VKM tranzitore, "sekret"); për një vlerësim cilësor të *akteve "Gri"* duhet aplikuar një tjetër përfaqje metodologjike, *nga brenda* arkivës së institucionit që ka miratuar aktin, dhe jo përmes ballafaqimit *nga jashtë* të burimeve publike ku publikohen këto akte (në rastin tonë VKM të botuar në FZ dhe në faqen zyrtare në internet të KM).

1 (Verifikimi Skematik është diferenca midis totalit të akteve të nxjerra brenda një viti nga institucioni dhe totalit të akteve të atij institucioni të botuar në FZ për atë vit.)

ANALIZA E BOTUESHMËRISË 2006-2010

Vendime të Këshillit të Ministrave

Në **tabelën nr. 5** (përbri, djathtas), ofrohet një paraqitje e detajuar në vlera numerike e totalit të VKM-ve që KM ka nxjerrë çdo vit (2006-2010), dhe atyre që gjenden *de facto* të botuar në Fletore Zyrtare të vitit përkatës.

Grafiku 1 paraqet vlerat në përqindje të raportit **VKM të nxjerra në një vit / VKM të botuara de-facto në FZ për atë vit**. Sikurse shihet qartë, treguesit janë në përmirësim të vazhdueshëm: nga 40% në 2006-ën në gati 80% në 2010-ën. Për skrupulozitetet metodologjik duhet rithekuar se kjo “trajektore” synon thjesht të krijojë një ide sa sa VKM (nuk) dërgohen për botim në Fletore Zyrtare çdo vit. Ky grafik nuk cakton dosmosdoshmërisht **botueshmërinë e aktit; VKM** në kuptim të pastër të fjalës, pasi një pjesë e akteve në fjalë janë me natyrë tranzitore ose “sekret” (shih: shpjegimin metodologjik fq 38, majtas).

TABELA nr.6

Viti	VKM në total të miratuara	VKM të botuara në faqen e KM	VKM të miratuara kundrejt atyre të publikuara online
2006	893	399	44.7%
2007	924	576	62.3%
2008	1720	1230	71.5%
2009	1305	1048	80.3%
2010	1080	625	57.9%

Grafiku 2: Botueshmëria e VKM në faqen zyrtare ne internet të KM





TABELA nr.5

Viti	VKM në total të miratuara	VKM të botuara në FZ	VKM të miratuara kundrejt atyre të botuara, në %
2006	893	369	41.3%
2007	924	465	50.3%
2008	1720	1067	62.0%
2009	1305	803	61.5%
2010	1080	821	76.0%

Grafiku 1: Botueshmëria e VKM në FZ çdo vit






Metodologjia “ÇIP” gërrshëton dy hallka monitoruese: verifikimin **Skematik** dhe atë **Faktik**. Nëse për të parin do të mjaftonte vetëm një hulumtim i kujdesshëm i FZ, për të dytin, nevojitet ballafaqimi i të dhënave mes të paktën dy burimeve zyrtare ku publikohen (bëhen publike) aktet objekt monitorimi. Njëri nga këta dy burime është vetë Fletorja Zyrtare, kurse tjetri, sipas rastit mund të jetë faqja zyrtare e insitucionit që nxjerr aktin, raporte/strategji zyrtare ku ofrohen përmbledhje të akteve të miratuara, etj.. Sa më e gjerë baza e ballafaqimit, aq më shumë është e mundur të identifikohen atributet e akteve të lëna jashtë botimi.



Në rastin VKM-ve, ballafaqohet përmbajtja e FZ dhe e faqes në internet të KM. Kjo e fundit, pavarësisht se është një nga faqet me më shumë të dhëna mbi aktet e nxjerra, krahasuar me çdo insitucion tjetër, shënon një rënie të performancës në vitin 2010 (**grafiku 2**), ku për herë të parë në FZ gjenden më shumë VKM të botuar se sa ka faqja zyrtare në internet. Në **tabelën nr. 6** jepen edhe vlerat numerike të VKM të nxjerra në total, atyre që janë të botuar në FZ çdo vit, dhe atyre që mund të gjenden edhe në faqen e internetit të KM.



Grafikët e paraqitur në këtë faqe paraqesin vëllimin që zenë VKM-të e tipeve të ndryshme në raport me njëra tjetrën dhe njëkohësisht në raport me botimin e tyre në FZ, për çdo vit në analizë (2006-2010). Vlerat numerike mbi të cilat janë përlogaritur përqindjet në grafik, ofohen të detajuara në Tabelën nr.7 në fund të faqes, ku ngjyrat e secilës kolonë shërbejnë edhe si legjende për leximin e grafikëve.



Analiza diferencuese e përdorur në ndërtimin e grafikëve, synon të demonstrojë ndër të tjera madhësinë reale të **Zonës Gri** ku grupohen të gjitha VKM-të e pabotuara për çdo vit, identifikimi i të cilave (titull, datë, indeks) është i pamundur përmes Metodologjisë "ÇIP". **Zona Gri** në këtë rast përfaqëson totalin e VKM-ve për të cilat ka dijeni vetëm Qeveria, ose e thënë ndryshe, janë të panjohura për shqiptarët e zakonshëm. Se çfarë natyre mund të kenë këto VKM (të gjitha VKM "sekrete", të gjitha VKM "jo-sekrete" definitive, të gjitha VKM "jo-sekrete" jo-definitive, apo një përzjerje e të trejave), kjo nuk mund të përcaktohet dot për aktet që qëndrojnë në **Zonën Gri**. Për këtë arsye, këta grafikë nuk mund të shërbejnë për vlerësimin në terma cilësorë të performancës së KM apo në përlogaritjen e saktë të **nivelit të zbatueshmërisë të nenit 29, ligji 9000** nga vetë KM.



Tabelë - Legjendë nr. 7

Viti	Totali i nxjerrë në 1 vit	VKM të botuara në FZ	VKM "për propozim projektligji"	VKM "për miratim në parim"	VKM të pabotuara gjetur nga ÇIP	VKM të botuara FZ Ekstra	Zona GRI
2006	883	369	67	44	93	77	233
2007	924	154	102	62	69	70	467
2008	1720	1067	117	62	218	66	190
2009	1305	803	109	68	95	95	135
2010	1081	821	69	54	25	N/A	112



ANALIZA E BOTUESHMËRISË 2006-2010



Akte Normative me Fuqinë e Ligjit

Nga monitorimi i Fletoreve Zyrtare të nxjerra gjatë periudhës 2006 -2010, për llojin e aktit “**ANFL**”, janë konstatuar mungesa në botim gjatë viteve 2006 dhe 2008. Në tabelën nr. 8 (djathtas) ofrohet një paraqitje e totalit të ANFL të miratuara nga Këshilli i Ministrave si dhe botueshmëria e tyre në FZ në vlera numerike për çdo vit, bazuar në të dhënat e raporteve të Transparencës së Botimeve Zyrtare në Republikës së Shqipërisë, që nga viti 2006 e deri në vitin 2010.

Viti	Totali i ANFL të miratuara	ANFL të botuara në FZ	ANFL të pabotuara në FZ
2006	2	1	0
2007	2	2	0
2008	7	3	4
2009	10	10	0
2010	6	6	0

TABELA nr.8

Grafiku 1: Botueshmëria e aktit për çdo vit




Legjenda: ■ Të botuara ■ Të pabotuara

Në **Grafikun 1** jepet një vizualizim i **botueshmërisë vjetore** të aktit: **ANFL** në FZ, për periudhën kohore 2006-2010.

Në **Grafikun 2**, paraqitet **mesatarja e botueshmërisë** në FZ të aktit: **ANFL** për të pestat vitet (2006-2010) të marra së bashku. Ky grafik indikon njëkohësisht edhe nivelin e zbatueshmërisë së nenit 29, pika 1, të ligjit 9000, dt 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, i cili i cakton këtij të fundit detyrimin për botim në FZ të aktit në fjalë.

Në **Grafikun 3** vizualizohet **trendi i botueshmërisë** në FZ për llojin e aktit: **ANFL**, për periudhën 2006-2010.

Grafiku 3: Trendi i botueshmërisë së aktit



Sikurse sugjerojnë **Grafikët 1** dhe **2**, situata e botimit të llojit të aktit: **ANFL** në Fletore Zyrtare paraqitet me probleme gjatë viteve 2006 dhe 2008. Në dy vitet e fundit (2009 dhe 2010), situata është ri-stabilizuar në vlerat maksimale pozitive (100% e ANFL-ve të botuar në FZ), siç sugjeron edhe **trendi i botueshmërisë** së aktit (**Grafiku 3**).



Mbi botueshmërinë e udhëzimeve

E drejta për të nxjerrë udhëzim i përket vetëm organit që i është njohur shprehimisht një e drejtë e tillë. Sipas Kushtetutës, *udhëzimi nxirret vetëm nga Këshilli i Ministrave dhe ministri* (neni 100/5 & 102/4).

Ligji Nr. 9000, datë 30.1.2003 *“Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”*, përcakton qartë përmes nenit 29, paragrafi 3, se: *“Udhëzimet e Këshillit të Ministrave dhe të ministrit marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare”*. Ky përcaktim ligjor implikon natyrën normative të këtij lloj akti, i cili detajon, sygjeron dhe këshillon, nëpërmjet orientimeve të shtjelluara e të zbërthyer me hollësi, të gjitha urdhërimet që ka vendosur ligji¹. Udhëzimi është praktikisht akti më i rëndësishëm që firmos një ministër gjatë ushtrimit të funksioneve të tij.

Për fat të keq, monitorimet e realizuar nga ÇIP për këto 5 vitet e fundit kanë nxjerrë në pah probleme serioze sa i takon rregullsisë së botimit në Fletore Zyrtare të udhëzimeve të ministrave.

Për më tepër, praktika e ndjekur për indeksimin e këtij lloj akti nuk është e standartizuar. Vetëm një pjesë e ministrave, konkretisht ajo e Financave, Ministria e Arsimit (MASH), Ministria e Transporteve (MPPT), Minisitri e Mjedisit (MMPAU) dhe ajo e Bujqësisë (MBUMK) përdorin varg të rregullt indeksimi për udhëzimet e tyre. Ky është një varg indeksues që bazohet mbi rendin numerik rritës, me bazë kalendarike². Edhe Këshilli i Ministrave, përdor të njëjtin sistem indeksimi për udhëzimet që ai nxjerr. Ky është praktikisht i njëjti sistem indeksimi që përdoret për VKM-të, apo edhe për vendimet e Gjykatës Kushtetuese² dhe mund të konsiderohet fare mire tashmë si sistemi standard që aplikohet në Republikën e Shqipërisë për indeksimin e akteve më të rëndësishme që nxjerrin institucionet qëndrore kushtetuese. Ai është një sistem indeksimi efikas dhe i konsoliduar.

Ministritë, të cilat do të renditen më poshtë, përdorin një sistem të ndryshëm “indeksimi” për udhëzimet që nxjerrin. Në fakt, me tepër sesa indekse aktesh, ato mund të konsiderohen numra “arbitrarë” të cilët “pagëzojnë” udhëzimin pa ndonjë kriter kronologjik apo numerik të caktuar. Nuk përjashtohet në ndonjë rast mundësia që, numri indeksues të jetë i prejardhur nga vargjet indeksuese të vitet pararendëse. Në secilin nga rastet, kjo e bën të pamundur vlerësimin e rregullsisë së vargut, element bazë mbi të cilin mbështetet metoda monitorues që përdor ÇIP. Ministritë që nuk përdorin vargun standard indeksues për udhëzimet që firmosen nga titullarët e tyre janë:

1. Ministria e Drejtësisë
2. Ministria e Brendshme
3. Ministria Punës, Çështjeve Sociale....
4. Ministria e Ekonomisë
5. Ministria e Shëndetësisë.

Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), ajo e Kulturës Rinisë dhe Sporteve (MKRS) si dhe Ministria e Integritetit (MI) nuk janë përfshirë në këtë monitorim për shkak të numrit të papërfillshëm të udhëzimeve që ato nxjerrin gjatë harkut kohor të një viti kalendarik, mbi të cilin kryhet vlerësimi i Raporteve të Transparenës së Botimeve Zyrtare.

Për të gjitha këto arsye, objekt vlerësimi i përqindjes dhe trendit të botueshmërisë së aktit: **udhëzim** (viti pas viti dhe në total për periudhën 2006-2008), do të jenë vetëm ministritë të cilat përdorin varg standart indeksues për udhëzimet e tyre. Në **tabelën nr.9** paraqiten të përmbledhura për secilin vit, (periudha 2006-2010) vlerat numerike mbi botueshmërinë e aktit: **udhëzim**, bazuar në gjetjet e identifikuara nga ÇIP në kuadër të Raporteve të përvitshme "Transparenca e Botimeve Zyrtare në RSH". Mbi vlerat numerike në këtë tabelë janë përpunuar grafikët e botueshmërisë së aktit për secilën ministri.

1 “E Drejta Administrative 2” Sokol Sadushi, botimi i tretë i ripunuar, 2005, fq.62

2 Vargu hapet me nr. 1 që merr udhëzimi i parë për vitin përkatës dhe mbyllet me nr indeksues që merr udhëzimi i fundit për vitin (deri në 31 dhjetor).

VITI 2010

TABELA nr.9

EMRI I INSTITUCIONIT	UDHËZIME TË NXJERRA	UDHËZIME TË BOTUARA	UDHËZIME TË PABOTUARA
KESHILLI I MINISTRAVE	8	8	0
MINISTRIA E FINANCEVE	47	32	14
MINISTRIA E ARSIMIT	38	24	14
MINISTRIA E MPPT	28 (1 me fraksion)	22	6
MINISTRIA E BUJQËSISË	19	1	18
MINISTRIA E MJEDISIT	7	6	1

VITI 2009

KËSHILLI I MINISTRAVE	2	2	0
MINISTRIA E FINANCEVE	56 (4 me fraksione)	33	23
MINISTRIA E ARSIMIT	41	3	38
MINISTRIA E PPTT	11	6	5
MINISTRIA E BUJQËSISË	3	1	2
MINISTRIA E MJEDISIT	3	1	2

VITI 2008

KËSHILLI I MINISTRAVE	3	3	0
MINISTRIA E FINANCEVE	48 (7 me fraksione)	39	9
MINISTRIA E ARSIMIT	45	22	23
MINISTRIA E PPTT	24 (1 me fraksion)	11	13
MINISTRIA E BUJQËSISË	6 (1 me fraksion)	2	4
MINISTRIA E MJEDISIT	5	4	1

VITI 2007

KËSHILLI I MINISTRAVE	6	6	0
MINISTRIA E FINANCEVE	30 (1 me fraksion)	24	6
MINISTRIA E ARSIMIT	41	5	36
MINISTRIA E PPTT	20	12	8
MINISTRIA E BUJQËSISË	12 (1 me fraksion)	3	9
MINISTRIA E MJEDISIT	10	5	5

VITI 2006

KËSHILLI I MINISTRAVE	5	5	0
MINISTRIA E FINANCEVE	12	12	0
MINISTRIA E ARSIMIT	49	3	46
MINISTRIA E PPTT	7	4	3
MINISTRIA E BUJQËSISË3	2	2	0
MINISTRIA E MJEDISIT	7	6	1



ANALIZA E BOTUESHMËRISË 2006-2010

Udhëzime të Këshillit të Ministrave

Nga monitorimi i Fletoreve Zyrtare të nxjerra gjatë periudhës 2006-2010, për llojin e aktit: **"Udhëzim i KM"** nuk është konstatuar asnjë mungesë në botim. Në **tabelën 10** (djathtas) ofrohet një paraqitjeje e detajuar në vlera numerike e totalit të **Udhëzimeve** që ka nxjerrë Këshilli i Ministrave vit pas vitit gjatë periudhën në shqyrtim. Tabela paraqit gjithashtu sa prej Udhëzimeve të KM janë të botuara në Fletore Zyrtare (ose jo) për secilin vit, sipas të dhënave që ofrojnë Raportet "Transparenca e Botimeve Zyrtare".

Viti	Totali i udhëzimeve	Udhëzime të botuara në FZ	Udhëzime të pabotuara në FZ
2006	5	5	0
2007	6	6	0
2008	3	3	0
2009	2	2	0
2010	8	8	0

TABELA nr.10


Grafiku 1: Botueshmëria e aktit për çdo vit



Botueshmëria vjetore në FZ për llojin e aktit: **Udhëzim i KM**, është 100% në çdo vit, periudha 2006-2010 (Grafiku 1).

Mesatarja e botueshmërisë (2006-2010) në FZ për llojin e aktit: **Udhëzim i KM** është gjithashtu 100% (Grafiku 2). Ky grafik indikon gjithashtu se niveli i zbatueshmërisë së nenit 29, pika 3, të ligjit 9000, dt 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", është po ashtu 100%.


Grafiku 2: Botueshmëria e aktit në pesë vite



Legjenda: ■ Të botuara ■ Të pabotuara

Rrjedhimisht, edhe **trendi i botueshmërisë** së aktit: **Udhëzim i KM** (Grafiku 3) është një vijë e drejtë horizontale, e cila në boshtin vertikal qëndron në vlerën 100% për të pestë vitet që janë marrë në shqyrtim.

Grafiku 3: Trendi i botueshmërisë së aktit



ANALIZA E BOTUESHMËRISË 2006-2010

Udhëzime të Ministrisë së Financave

Nga monitorimi i Fletoreve Zyrtare të nxjerra gjatë periudhës 2006-2010, për llojin e aktit: **Udhëzim i MF**, janë konstatuar mungesa gjatë çdo viti. Në **tabelën nr.11** (djathtas) ofrohet një paraqitjeje e detajuar në vlera numerike e **Udhëzimeve të MF** vit pas viti (2006-2010). Tabela paraqit gjithashtu sa prej Udhëzimeve të MF janë të botuara në FZ (ose jo) për çdo vit, sipas gjetjeve të Raporteve të përvitshme "Transparenca e Botimeve Zyrtare në Republikën e Shqipërisë".


Viti	Totali i udhëzimeve	Udhëzime të botuara në FZ	Udhëzime të pabotuara në FZ
2006	12	12	0
2007	30	24	6
2008	48	38	9
2009	56	33	23
2010	47	32	14

TABELA nr. 11

Grafiku 1: Botueshmëria e aktit për çdo vit



Grafiku 2: Botueshmëria e aktit në pesë vite




Legjenda: ■ Të botuara ■ Të pabotuara

Sa i takon **botueshmërisë vjetore** në FZ për llojin e aktit: **Udhëzim i MF**, vetëm në vitin 2006 ajo ka qenë 100%. **Grafiku 1** sugjeron se vlerat më të ulëta të botueshmërisë së aktit kanë qenë në vitin 2009, me 59%.

Në 2010-ën botueshmëria është përmirësuar krahasuar me 2009-ën, edhe pse si vlerë vjetore është nën **mesataren e botueshmërisë për të pestë vitet**, që është 78 % (**Grafiku 2**). Kjo vlerë, pra 78%, cakton edhe nivelin e zbatueshmërisë së dispozitave relevante që caktojnë detyrimin për botim në FZ të udhëzimeve nga ana e Ministrisë së Financave.

Trendit i botueshmërisë së udhëzimeve të MF është në rënie (përkeqësues), sikurse sugjeron qartë edhe Grafiku 3. Vlerat kanë pësuar vetëm rënie nga 2006-ta deri në 2009-ën, dhe shënojnë një rritje (përmirësim) vetëm në 2010-ën (**Grafiku 3**). Megjithatë, vlerat e 2010-ës ia kalojnë vetëm 2009-ës, por në asnjë rast vlerave të botueshmërisë në vitet 2006-2007 dhe 2008.

Grafiku 3: Trendi i botueshmërisë së aktit



ANALIZA E BOTUESHMËRISË 2006-2010


Udhëzime të Ministrisë së Arsimit

Nga monitorimi i Fletoreve Zyrtare të nxjerra gjatë periudhës 2006 -2010, për llojin e aktit: **Udhëzim i MASH**, janë konstatuar mungesa të shumta gjatë çdo viti. Në **Tabelën 12** (djathtas) ofrohet një paraqitjeve e detajuar në vlera numerike e **Udhëzimeve të MASH** vit pas viti (2006-2010). Tabela paraqit gjithashtu sa prej Udhëzimeve të MASH janë të botuara në FZ dhe sa prej tyre jo, bazuar në gjetjet e Raporteve të përvitshme "Transparenca e Botimeve Zyrtare në Republikën e Shqipërisë".


Viti	Totali i udhëzimeve	Udhëzime të botuara në FZ	Udhëzime të pabotuara në FZ
2006	49	3	46
2007	41	5	36
2008	45	22	23
2009	41	3	38
2010	38	24	14

TABELA nr.12

Grafiku 1: Botueshmëria e aktit për çdo vit



Grafiku 2: Botueshmëria e aktit në pesë vite




Legjenda: ■ Të botuara ■ Të pabotuara

Grafiku 1 sugjeron se **botueshmëria vjetore** e Udhëzimeve të MASH në FZ është nga më të ultat. Në vitet 2006 dhe 2009 ajo zbret deri në vlerat 7%. Vetëm në vitin 2010 vihet re për herë të parë që botueshmëria e aktit (63%) të jetë me lartë në vlerë numerike se sa pa-botueshmëria e tij.

Mesatarja e botueshmërisë në 5 vite për Udhëzimet e MASH është vetëm 27.4% (**Grafiku 2**). Rrjedhimisht, edhe niveli i zbatueshmërisë së dispozitës 29/3, ligji 9000 nga MASH është po 27.4%. Nesë kjo do të ishte njëkohësisht edhe një notë vlerësuese për detyrën e saj "të shtëpisë", që i ka caktuar ligji 9000, atëherë MASH nuk do ta kalonte dot klasën.

Trendi i botueshmërisë së udhëzimeve të MASH është një vijë e cila pothuajse prek "dyshe-menë" në 2006-ën dhe 2009-ën. Edhe pse në 2010-ën, trendi ngjitet deri tek gjashta (për të përdorur sërish "vlerësimin" prej arsimitari), përsëri, ai mbetet një rezultat i dobët (**Grafiku 3**).

Grafiku 3: Trendi i botueshmërisë së aktit



ANALIZA E BOTUESHMËRISË 2006-2010


Udhëzime të Ministrisë së Transporteve

Nga monitorimi i Fletoreve Zyrtare të nxjerra gjatë periudhës 2006 -2010, për llojin e aktit: **Udhëzim i MPPT**, janë konstatuar gjithashtu mungesa gjatë çdo viti. Në **Tabelën 13** (djathtas) ofrohet një paraqitjeve e detajuar në vlera numerike e **Udhëzimeve të MPPT** vit pas viti (2006-2010). Tabela paraqit gjithashtu sa prej Udhëzimeve të MPPT janë të botuara në FZ (ose jo) për çdo vit, sipas gjetjeve të Raporteve të përvitshme "Transparenca e Botimeve Zyrtare në Republikën e Shqipërisë".


Viti	Totali i udhëzimeve	Udhëzime të botuara në FZ	Udhëzime të pabotuara në FZ
2006	7	4	3
2007	20	12	8
2008	24	11	13
2009	3	1	2
2010	28	22	6

TABELA nr.13

Grafiku 1: Botueshmëria e aktit për çdo vit



Grafiku 2: Botueshmëria e aktit në pesë vite




Legjenda: ■ Të botuara ■ Të pabotuara

Grafiku 1 vizualizon **botueshmërinë vjetore** në FZ të udhëzimeve të MPPT (periudha kohore 2006-2010). Vlerat më të ulëta i ka viti 2008, me vetë 46% të udhëzimeve të botuara në FZ. Çdo vit tjetër, vlerat e botueshmërisë së aktit nuk bien nën 50%.

Mesatarja e botueshmërisë 5-vjeçare (2006-2010) së udhëzimeve të MPPT në FZ është 59.8% (**Grafiku 2**). Ky është rrjedhimisht edhe niveli i zbatueshmërisë së nenit 29, pika 3, të ligjit 9000, dt. 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" nga kjo ministri (MPPT).

Trendi i botueshmërisë në FZ të udhëzimeve të MPPT është një vijë e thyer, e cila për katër vite rrjesht, 2006-2009 i "spërdridhet" nivelit 50%. Vetëm në vitin 2010 shënohet një rritje e ndjeshme e trendit krahasuar me vitet paraardhëse. Sikurse sugjeron **Grafiku 3**, që nga viti 2008, kur botueshmëria e aktit prek vlerat më të ulëta, e deri në 2010-ën, kemi një rritje të qëndrueshme sa i takon botimit të udhëzimeve në FZ nga kjo ministri. Si përfundim, mund të thuhet se trendi ka prirje përmirësuese.

Grafiku 3: Trendi i botueshmërisë së aktit



ANALIZA E BOTUESHMËRISË 2006-2010


Udhëzime të Ministrisë së Mjedisit

Nga monitorimi i Fletores Zyrtare, periudha 2006-2010, për llojin e aktit: **Udhëzim i MMPAU**, janë konstatuar gjithashtu mungesa gjatë çdo viti. Në **Tabelën 14 (djathtas)** ofrohet një paraqitjeje e detajuar në vlera numerike e **Udhëzimeve të MMPAU** vit pas viti (2006-2010). Tabela paraqit sa prej Udhëzimeve të MPPT janë gjetur të botuara në FZ dhe sa prej tyre për çdo vit, bazuar në konkluzionet e Raporteve të përvitshme "Transparenca e Botimeve Zyrtare në Republikën e Shqipërisë".

Viti	Totali i udhëzimeve	Udhëzime të botuara në FZ	Udhëzime të pabotuara në FZ
2006	7	5	2
2007	10	5	5
2008	5	4	1
2009	3	1	2
2010	7	6	1

TABELA nr. 14

Grafiku 1: Botueshmëria e aktit për çdo vit



Grafiku 2: Botueshmëria e aktit në pesë vite




Legjenda: ■ Të botuara ■ Të pabotuara

Botueshmëria vjetore e Udhëzimeve të MMPAU arrijn vlerën më të ulët në vitin 2009, me rreth 33%. Vlera më e lartë për të pestat vitet në shqyrtim, arrihet në 2010-ën, me 86% të udhëzimeve të botuara (**Grafiku 1**).

Mesatarja e botueshmërisë së udhëzimeve të MMPAU (2006-2010) është 65% (**Grafiku 2**). Kjo vlerë, pra 65%, përfaqëson edhe nivelin e zbatueshmërisë së nenit 29/3, të ligjit 9000, dt. 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" nga kjo ministri (MMPAU).

Trendi i botueshmërisë së aktit (udhëzime të MMPAU, 2006-2010) është me ulje- ngritje. Vlerat rënëse dhe ato rritëse asnjansojnë njëra tjetrën vit pas viti, duke e bërë praktikisht të pamundur vlerësimin e performancës (qoftë ky pozitiv apo negativ). Mbetet gjithsesi të theksohet se 2010-ta shënon vlerat më të larta të botueshmërisë së aktit, krahasuar me vitet paraardhëse, çka mund të interpretohej si një sinjal pozitiv (deri në daljen e rezultateve për vitin 2011).

Grafiku 3: Trendi i botueshmërisë së aktit



ANALIZA E BOTUESHMËRISË 2006-2010


Udhëzime të Ministrisë së Bujqësisë

Nga monitorimi i Fletores Zyrtare, periudha 2006-2010, për llojin e aktit: **Udhëzim i MBUMK**, konstatohet një përqendrim konstant i botueshmërisë së aktit. Në **Tabelën 15** (djathtas) ofrohet një paraqitjeje e detajuar në vlera numerike e **Udhëzimeve të MBUMK** vit pas viti (2006-2010). Tabela paraqit sa prej udhëzimeve të MBUMK janë gjetur të botuara (ose jo) në FZ për çdo vit, bazuar në konkluzionet e Raporteve të përvitshme "Transparenca e Botimeve Zyrtare në Republikën e Shqipërisë".


Viti	Totali i udhëzimeve	Udhëzime të botuara në FZ	Udhëzime të pabotuara në FZ
2006	2	2	0
2007	12	3	9
2008	6	2	4
2009	3	1	2
2010	19	1	18

TABELA nr. 15

Grafiku 1: Botueshmëria e aktit për çdo vit



Grafiku 2: Botueshmëria e aktit në pesë vite




Sikurse sugjerojnë vlerat e **Grafikut 1**, **botueshmëria vjetore e aktit** (udhëzim i MBUMK) ka zbritur nga 100% në vitin 2006, në vlerën minimale prej vetëm 5% në vitin 2010. Vihet re po ashtu se, sa më shumë udhëzime brenda një viti të nxjerrë MBUMK, aq më e ulët tenton të jetë vlera e botueshmërisë së aktit.

Trendi i botueshmërisë së aktit (**Grafiku 3**) ka formën e një "shezlongu", këmbët e të cilit janë vitet 2007 dhe 2010, kurse pjesa ku "koka qëndron lart", është viti 2006.

Mesatarja e botueshmërisë së aktit: Udhëzim i MBUMK për të pesta vitet (2006-2010) është 39.6%. Sikurse është bërë e qartë tashmë, kjo është edhe vlera që cakton nivelin e zbatueshmërisë së ligjit (neni 29/3, ligji 9000, dt. 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave") nga MBUMK sa i takon botimit të udhëzimeve të veta në FZ.

Nëse do të rrumbullakosej kjo vlerë zbatueshmërie, (jo në %), ajo do të ishte një "4 me hatër", që e le gjithësi "në klasë" Ministrinë e Bujqësisë.

Grafiku 3: Trendi i botueshmërisë së aktit



ANALIZA E BOTUESHMËRISË 2006-2010

Vendimet Unifikuese të Gjykatës së Lartë

Vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare (neni 19/3, ligji nr. 8588 dt.15.03.2000 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të R.Sh."

Nga monitorimi i FZ të periudhës 2006 -2010, ka rezultuar i pabouar vetëm një VUGJL e vitin 2007 (**Tabela 16, djathtas**). Ndërkohë, situata paraqitet e stabilizuar sa i takon viteve të tjera të cilat janë marrë në shqyrtim në kuadër të raporteve "Transparenca e Botimeve Zyrtare".


Viti	Totali i VUGJL	VUGJL të botuara në FZ	VUGJL të pabotuara në FZ
2006	14	14	0
2007	27	26	1
2008	4	4	0
2009	18	18	0
2010	1	1	0

TABELA nr.16

Grafiku 1: Botueshmëria e aktit për çdo vit



Grafiku 2: Botueshmëria e aktit në pesë vite




Sikurse sugjeron **Grafiku 1, botueshmëria vjetore e VUGJL** bie nga vlera absolute 100% vetëm në vitin 2007 (nga 9 vendime unifikuese gjithsej, në FZ 2007 u gjetën të botuara vetëm 8, ose 89% e totalit).

Mesatarja e botueshmërisë së VUGJL në FZ për të pesta vitete (2006-2010) së bashku është 99.2%. Ky është njëkohësisht edhe niveli i zbatimit të dispozitës 19/3, të ligjit nr.8588 dt.15.03.2000 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të R.Sh" nga vetë Gjykata e Lartë.

Në **Grafikun 3** vizualizohet **trendi i botueshmërisë** në Fletore Zyrtare të VUGJL-ve, për periudhën 5-vjeçare, 2006-2010. Ai paraqitet i stabilizuar (niveli 100%), me përjashtim të vitit 2007, ku ka pësuar një rënie me 4% nga vlera maksimale.

Grafiku 3: Trendi i botueshmërisë së aktit



ANALIZA E VONESAVE NË BOTIM, 2006-2010

Vendimet Unifikuese të Gjykatës së Lartë

Në kuadër të raporteve të përvitshme *"Transparenca e Botimeve Zyrtare në RSH"*, objekt monitorimi dhe vlerësimi ka qenë edhe afati ligjor i botimit të VUGJL në Fletore Zyrtare.

Ligji nr.8588 dt.15/03/2000 *"Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të R.Sh."*, i ka kush-tuar një rëndësi të veçantë afateve të botimit të VUGJL, të cilat njësisht (unifikojnë) praktikën e shqyrtimit gjyqësor në të gjitha gjykatat e shkallëve më të ulëta të vendit. Neni 19 i ligjit 8588, përcak-ton shprehimisht se:

1. *Vendimet e Gjykatës së Lartë shpallen të arsy-etuara jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor.*
2. *Vendimet e kolegjeve të Gjykatës së Lartë, së bashku me mendimet e pakicës, botohen në Bu-letin Periodik të Gjykatës së Lartë.*
3. *Vendimet për njësimin ose ndryshimin e prak-tikës gjyqësore botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.*

Nisur nga përcaktimi eksplisit i nenit 19/3, autorët e monitorimit kanë përllogaritur se cili duhet të ishte *"numri më i parë i Fletores Zyrtare"* ku duhej botuar VUGJL, duke e nisur numërimin nga data e shpal-ljes së vendimit (*marzhi i gabimi njerëzor: 5-10%*). Është e qartë se çdo vonesë në shpalljen e VUGJL, në

kundërshtim me përcaktimet kohore që vendos neni 19, pika 1, do të çonte automatikisht edhe në shkelje të pikës 3 të të njëjtit nen (19).

Në *Tabelën nr. 18, fq 52*, jepet një paraqitje e plotë e VUGJL-ve për të pesta vitet në shqyrtim (2006-2010). Në dy kolonat e fundit, në anën e djathtë të tabelës, janë praqitur respektivisht numrat e FZ ku gjendet i botuar VUGJL si dhe numri i FZ ku autorët e monitorimit vlerësojnë se duhej të ishte botuar akti (*duke lënë një muaj tolerance/avancë në përllogaritjen e kohës*), në respekt të dispozitës 19/3, të ligjit nr.8588 dt.15/03/2000 *"Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë"*.

Grafiku 1 paraqet *trendin e vonesave në botim të VUGJL*, ndërkohë që në *Tabelën nr. 17* jepen gjetjet në vlera numerike, si edhe specifikime të tjera të nevo-jshme për llojin e aktit: *VUGJL* (periudha 2006-2010).




Tabela Nr. 17

VITI	VENDIME TË KOLEGJEVE TË BASHKUARA, G.J.L.	VUGJL	VUGJL CIVILE	VUGJL PENALE	VUGJL TË PABOTUARA NË FZ	VONESA MESATARE E BOTIMIT NË F.Z.
2010	2	1	1	0	0	4 muaj
2009	18	8	3	5	0	4.2 muaj
2008	4	2	1	1	0	6.1 muaj
2007	27	9	1	8	1	2.3 muaj
2006	14	6	6	0	0	3.3 muaj



ANALIZA E VONESAVE NË BOTIM, 2006-2010

Tabela Nr. 18 - Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, 2006-2010

Viti	Nr.	Numri indeksues i Vendimit Unifikues (VU)	Data e Vendimit Unifikues	Fletorja Zyrtare ku është botuar VU	Fletorja Zyrtare ku duhej botuar VU
2010	1	Nr.2 i Regj. Themeltar Nr.1 i Vendimit	26.11.2011	nr.74 (Ekstra) Prill 2011	Nr.157 30/11/2010
2009	1	Nr.6/4 i Regj. Themeltar Nr.1 i Vendimit	6.1.2009	Nr.171 Dt. 9/12/2009	Nr.8 Dt. 9/2/2009
	2	Nr.5/3 i Regj. Themeltar Nr.2 i Vendimit	6.1.2009	Nr.82 Dt. 8/6/2009	Nr.8 Dt. 9/2/2009
	3	Nr.7/5 i Regj. Themeltar Nr.5 i Vendimit	20.1.2009	Nr.102 Dt. 8/7/2009	Nr.13 Dt. 20/02/09
	4	Nr.4/3 i Regj. Themeltar Nr.1 i Vendimit	8.1.2009	Nr.117 Dt. 10/8/2009	Nr.8 Dt. 9/2/2009
	5	Nr.6/5 i Regj. Themeltar Nr.2 i Vendimit	6.2.2009	Nr.125 Dt. 24/08/09	Nr.21 Dt. 6/3/2009
	6	Nr.9 i Regj. Themeltar Nr.4 i Vendimit	24.6.2009	N.125 Dt. 24/08/09	Nr.112 Dt. 24/07/09
	7	Nr.2/1 i Regj. Themeltar Nr.5 i Vendimit	15.9.2009	Nr.171 Dt. 9/12/2009	Nr.145 Dt. 20/10/09
	8	Nr.6/5 i Regj. Themeltar Nr.2/1 i Vendimit	2/10/2009	Nr.162 Dt. 27/11/09	Nr.148 Dt. 2/11/2009
2008	1	Nr.8 i Regj. Themeltar Nr.3 i Vendimit	12/2/2008	Nr.150 3/10/2008	Nr.37 12/3/2008
	2	Nr.1 i Regj. Themeltar Nr.1 i Vendimit	27/03/2008	Nr.149 24/09/08	Nr.59 25/04/08
2007	1	Nr.2/2 i Regj. Themeltar Nr.1 i Vendimit	25/01/07	Nr.97 1/8/2007	Nr.18 24/02/07
	2	Nr.8/1 i Regj. Themeltar Nr.3 i Vendimit	24/01/07	Nr.18 24/02/07	Nr.18 24/02/07
	3	Nr.10/3 i Regj. Themeltar Nr.5 i Vendimit	22/01/07	Nr.30 23/03/07	Nr.15 22/02/07
	4	Nr.9/2 i Regj. Themeltar Nr.6 i Vendimit	24/01/07	Nr.97 1/8/2007	Nr.18 24/02/07
	5	Nr.1 i Regj. Themeltar Nr.8 i Vendimit	12/9/2007	Nr.150 13/11/07	Nr.133 11/10/2007
	6	Nr.4 i Regj. Themeltar Nr.10 i Vendimit	12/9/2007	Nr.156 27/11/07	Nr.133 11/10/2007
	7	Nr.12/5 i Regj. Themeltar Nr.19 i Vendimit	15/11/07	Nr.191 7/2/2008	Nr.168 17/12/07
	8	Nr.5 i Regj. Themeltar Nr.20 i Vendimit	15/11/07	Nr.191 7/2/2008	Nr.168 17/12/07
2006	1	Nr.11/2 i Regj. Themeltar Nr.1 i Vendimit	31/01/2006	Nr.43 Dt 10/05/06	Nr.13 Dt.01/03/06
	2	Nr.13/4 i Regj. Themeltar Nr.3 i Vendimit	3/2/2006	Nr.43 Dt 10/05/06	Nr.16 Dt.06/03/06
	3	Nr.12 i Regj. Themeltar Nr.4 i Vendimit	1/2/2006	Nr.34 Dt.14/04/06	Nr.13 Dt.01/03/06
	4	Nr.5 i Regj. Themeltar Nr.5 i Vendimit	3/3/2006	Nr.54 Dt 02/06/06	Nr.22 Dt.06/04/06
	5	Nr.7 i Regj. Themeltar Nr.9 i Vendimit	9/3/2006	Nr.119 Dt. 20/11/06	Nr.26 Dt. 10/04/06
	6	Nr.7 i Regj. Themeltar Nr.13 i Vendimi	9/3/2006	Nr.107 Dt.13/10/06	Nr.26 Dt.10/04/06



ANALIZA E BOTUESHMËRISË 2006-2010

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese

Nga monitorimi i Fletoreve Zyrtare të nxjerra gjatë periudhës 2006-2010, për llojin e aktit **“Vendim i Gjykatës Kushtetuese”**, nuk është konstatuar asnjë mungesë në botim (shih: **Tabela 19, djathtas**) ofrohet një paraqitjeje e detajuar e totalit të Vendimeve të GJK për secilin vit (2006-2010), bazuar në të dhënat e raporteve të përvitshme: "Transparenca e Botimeve Zyrtare në Republikës së Shqipërisë".

Viti	Totali i VGJK	VGJK të botuara në FZ	VGJK të pabotuara në FZ
2006	30	30	0
2007	45	45	0
2008	29	29	0
2009	32	32	0
2010	38	38	0

TABELA nr. 19


Grafiku 1: Botueshmëria e aktit për çdo vit



Botueshmëria vjetore e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është 100% në secilin prej viteve të marra në analizë për periudhën kohore 2006-2010 (**Grafiku 1**).

Rrjedhimisht, edhe **mesatarja e botueshmërisë** (periudha 2006-2010) së këtij lloji akti në FZ është 100% (**Grafiku 2**). Po ashtu 100% është edhe niveli i implementimit nga vetë Gjykata Kushtetuese e ligjit të saj organik, sa i takon detyrimit për botim në FZ të vendimeve të saj (neni 26, pika 1 & 2, ligji nr. 8577, datë 10.2.2000. "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të RSH").


Grafiku 2: Botueshmëria e aktit në pesë vite



Legjenda: ■ Të botuara ■ Të pabotuara

Trendi i botueshmërisë në FZ të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është një vijë e drejtë horizontale, e cila në boshtin vertikal qëndron në vlerën maksimale 100% për të gjithë periudhën 2006-2010 (**Grafiku 3**).

Grafiku 3: Trendi i botueshmërisë së aktit



REKOMANDIME

Është një vijueshmëri e pastër logjike që si fillim t'i rekomandohet institucioneve "dërguese" por edhe Qendrës së Publikimeve Zyrtare (*marrësi*), botimi në Fletore Zyrtare "Ekstra" i akteve të cilat janë evidentuar përmes këtij monitorimi si të pabotuara gjatë vitit 2010. Një praktikë e tillë është ndjekur edhe vitin e kaluar (2010) nga QPZ, e cila ka shtypur dhe ka hedhur në qarkullim një numër të konsiderueshëm Fletorësh Zyrtare "Ekstra", në të cilat u botuan mbi 400 akte nënligjore, kryesisht VKM, të cilat ishin "stok" i pabotuar që nga viti 2005. Ky edicion special Fletorësh Zyrtare Ekstra (unik në terma të volumit), edhe pse me vonesë, siguroi akses efektiv në një sërë aktesh, që ngjallën interes publik dhe mediatik.

Në rast se ky precedent pozitiv do të ripërsëritej, një rëndësi të posaçme i duhet kushtuar këtë herë edhe botimit të udhëzimeve të ministrave, pasi, sikurse është bërë e qartë tashmë në parashtrimet teorike të këtij Raporti (*legjitimiteti i monitorimit*), ato janë akte me natyrë normative dhe botimi i tyre në Fletore Zyrtare cakton momentin e hyrjes së tyre në fuqi. Teksa rekomandon botimin e udhëzimeve në FZ, pavarësisht se me vonesë, ÇIP mban parasysh parimin se *mosbotimi i një akti në Fletore Zyrtare nuk sjell detyrimisht pavlefshmërinë e tij, por pafuqinë e tij*; vetë pavlefshmëria gjykohet në kompleks. Efektet juridike që akti mund të ketë krijuar deri në momentin e botimit të tij, konsiderohen pa fuqi juridike dhe akti vetë si i paqenë dhe që nuk ekziston¹.

Së dyti, problemet e konstatuara përmes monitorimit të periudhës 5 vjeçare, 2006-2010, kanë nxjerrë qartësisht në pah nevojën për unifikim të sistemit të indeksimit të akteve, sidomos për udhëzimet e ministrave. Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë (METE) apo edhe Ministria e Shëndetësisë, nuk përdorin sistemin standart indeksimi për udhëzimet e tyre. Në fakt, me tepër sesa indekse aktesh, ato mund të konsiderohen numra protokolli të cilat "pagëzojnë" udhëzimin. Nuk përjashtohet në ndonjë rast mundësia që numri indeksues të jetë i prejardhur nga vitet pararendëse. Kjo e bën të pamundur vlerësimin e rregullsisë së vargut indeksues, element bazë mbi të cilin mbështetet metoda monitoruese që përdor ÇIP. Caktimi arbitrar i

atributeve të aktit minon angazhimet qeveritare të ndërmara së fundmi në nivel kombëtar edhe ndërkombëtar për qeverisje të hapur, transparente dhe të përgjegjshme.

Mbi të gjitha, kjo e bën të pamundur identifikimin e aktit nga individë të interesuar (subjekte të interesuar, profesionistë të ligjit, etj), duke kompromentuar aksesin efektiv në legjislacion. Kjo mund të influencojë negativisht (çon në ulje) edhe nivelin e zbatueshmërisë së vetë aktit. Merret si e mirëqenë se institucioni që nxjerr aktin ka interes parësor që ai të zbatohet prej subjekteve të cilave iu adresohet, dhe njoftimi i tij në mënyrë efektive i shërben pikërisht këtij qëllimi.

Një tjetër fenomen i cili është hasur mjaft shpesh në rastin e udhëzimeve të ministrave është edhe përcaktimi arbitrar i dispozitës që cakton momentin e hyrjes në fuqi të aktit. Ligji Nr. 9000, datë 30.1.2003 "**Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave**", përcakton qartë përmes nenit 29, paragrafi 3, se: "*Udhëzimet e Këshillit të Ministrave dhe të ministrit marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare*". Ky përcaktim ligjor implikon qartë se ky lloj akti nuk mund të hyjë në fuqi para botimit të tij në Fletore Zyrtare. Në kundërshtim me këtë përcaktim ligjor, dispozitat që caktojnë hyrjen në fuqi të udhëzimeve, në shumicën dërrmuese të rasteve kanë një formulim standart të tipit: "*ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë*".

ÇIP i rekomandon institucioneve që nxjerrin aktin, ndërprerjen e kësaj praktike që nuk mban parasysh përcaktimet ligjore dhe riformulimin e saj në frymën e ligjit 9000 "**Për organizimin dhe funksionimin e KM**", ku të caktohet në mënyrë eksplicite detyrimi për botim i aktit, dhe hyrja e tij në fuqi, pas botimit në Fletore Zyrtare. Është me rëndësi të theksohet në këtë kontekst se udhëzimi është akti më i rëndësishëm që një ministër nxjerr në ushtrim të funksioneve dhe detyrave qeverisëse. Për më tepër, nëse ligji normon në përgjithësi marrëdhëniet juridike në një fushë të caktuar, ajo që mbetet më e prekshme për *subjektin - zbatues* është pikërisht akti nënligjor, dhe veçanërisht udhëzimet e ministrit të linjës, të cilat përcaktojnë imtësisht modalitetet e zbatimit

1 "E Drejta Administrative 2" Sokol Sadushi, botimi i tretë i ripunuar 2005, fq.5

të ligjit dhe/apo VKM-ve në rastin konkret. Nga *subjekti-zbatues* kërkohet veçse operativitet. Prandaj, akses i *subjekti-zbatues* tek këto akte duhet të garantohet plotësisht përmes bërjes së tyre publike, madje jo vetëm përmes botimit në FZ (ligjërisht të përcaktuar), por edhe përmes websiteve të ministrive në një hapësirë të posaçme dhe lehtësisht të dallueshme (*user friendly*).

Rritja e kapaciteteve absorbuese dhe procesuese të vetë QPZ është një tjetër rekomandim që vjen në kuadër të këtij Raporti. Nga analiza e bërë për situatën 5 vjecare, 2006-2010, rezulton se volumi i akteve të cilat QPZ duhet të trajtojë çdo vit për botim në Fletore Zyrtare është relativisht i lartë. Padyshim që QPZ përballat çdo ditë me një sfidë të vërtetë profesionale për të përmbushur rigorozisht misionin e saj ligjor, skurse ai i është përcaktuar në ligjin 8502 **"Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare"** të ndryshuar.

ÇIP ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur (në të dyja raportet pararendëse) se premisat për mungesë kapacitetesh teknike dhe njerëzore të QPZ-së për botimin e gjithë këtij volumi aktesh, mund të eliminoheshin në rast se shteti shqiptar do të njihte efektin zyrtar të publikimit të FZ në format elektronik. Sigurisht, një nismë e tillë, në gjykimin e disa ekspertëve, mund të kërkonte disa interpretime të Kushtetutës. Është për t'u përsëritur që një rekomandim i tillë është marrë parasysh (janë duke u shqyrtuar disa ndryshime që synohen t'i bëhen ligjit 8502 **"Për krijimin e QPZ"**, të ndryshuar).

ÇIP e ka bërë të qartë tashmë qëndrimin e vet se si ndryshimi i ligjit 8502 **"Për krijimin e Qendrës së Publikimeve zyrtare"** të ndryshuar, të mos implikonte domosdoshmërisht edhe ndryshimin e Kushtetutës. Në mënyrë të thjeshtuar, ÇIP ka rekomanduar që botimi aktual në letër i FZ të vijojë po njësoj, vetëm se në një tirazh shumë herë më të reduktuar. Ndërkohë, ligji duhet caktojë modalitetet se kur një versioni elektronik i Fletore Zyrtare duhet konsideruar kopje identike e atij në letër. Kopjet elektronike të Fletore Zyrtare të hedhura në internet, do të kompensonin reduktimin e tirazhit në letër dhe njëkohësisht do të përmirësonin shumë aksesin e publikut në bankën e akteve. Nëse ky do të ishte edhe versioni që do të adoptohej në kuadër të amendimeve që synohet t'i bëhen **ligjit 8502, të ndryshuar** atëherë mund të printohen vetëm 100 kopje në letër, për efekt arkivor si dhe për t'i paraprirë çdo defekti apo manipulimi të mundshëm që mund të ndodhë me sistemet online. Këto kopje autentike në letër mund t'i dorëzoheshin institucioneve më të rëndësishme kushtetuese të

vendit, për t'i administruar ato në arkivat e tyre, pa harruar këtu Bibliotekën Kombëtare, Arkivën e Shtetit, apo ndonjë institucion tjetër të ngjashëm.

Ministria e Drejtësisë prej më shumë se një viti është duke punuar për draftimin e ndryshimeve që synohet t'i bëhen ligjit nr. 8502. Këto ndryshime pritet të adresojnë për zgjidhje edhe çështjen e botimit elektronik të Fletore Zyrtare. ÇIP do t'i rekomandonte MD në këtë kontekst të përshte më mirë në procesin e draftimit aktorët e specializuar të shoqërisë civile që kanë kontribute reale në fushën e aksesit në legjislacion. Vitin e kaluar, ÇIP organizoi një tryezë të nivelit të lartë teknik, me ekspertët më të njohur në fushën e botimeve zyrtare dhe të *e-governance*, ku morën pjesë edhe titullarë të Ministrisë së Drejtësisë. Rekomandimet e kësaj tryezë iu dërguan më pas të përmbledhura kësaj të fundit. ÇIP komisionoi dy ekspertë të njohur në vend në fushën e të drejtës administrative për një studim krahasues të mirëfilltë mbi praktikën e vendeve europiane në këtë drejtim, i cili gjithashtu iu dërgua për vlerësim të mëtejshëm Ministrisë së Drejtësisë. Tashmë është një fakt i njohur se shumica e vendeve europiane kanë "braktisur" publikimin në letër të Fletore Zyrtare. Këto vende kanë mbyllur tashmë shtypshkronja gjigande dhe kanë adoptuar një qasje krejtësisht të re, që garanton akses të lartë nga cilindo në bankën e akteve zyrtare, ulje të koston së botimit të Fletore Zyrtare, eliminimin e vonësive në shpërndarje etj.

Një tjetër rekomandim i ÇIP në kuadër të draftimit të ndryshimeve në **ligjin 8502, të ndryshuar**, do të ishte rakkordimi i afateve të botimit të akteve në Fletore Zyrtare që cakton vetë ky ligj me ato që caktonjnë respektivisht ligji organik për Gjykatën e Lartë (nr.8588) si dhe ai për Gjykatën Kushtetuese (nr. 8577).

Dhe së fundmi, një konsideratë lidhur me problemin e "stokut" të akteve ndërkombëtare të ratifikuar ndërvite nga Kuvendi, teksti i të cilave nuk është i botuar në shqip në FZ. ÇIP ka konstatuar tashmë se ky "stok" është disa herë më i madh se sa ai që ka arritur të evidentojë Avokati i Popullit në Raportin Specil nr. 1 që ai dorëzoi në Kuvend në datë 23/05/2008. ÇIP do të bëjë publike shumë shpejt edhe rezultatet e një vlerësimi tërësor të situatës në 20 vitet e fundit sa i takon akteve ndërkombëtare të pabotuara. Gjithsesi, për momentin i rekomandohet Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera relevante të procesojmë pa vonesa në drejtim të reduktimit të stokut që ka rekomanduar për botim në FZ Avokati i Popullit.



SHKURT MBI METODOLOGJINË "ÇIP"

Në terma të përgjithshme, Metodologjia "ÇIP" konsiston në dy hallka:

1. **Skematike** - Identifikimi i akteve të pabotuara në Fletore Zyrtare, përmes shqyrtimit të vargut indeksues, ku çdo numër në varg i korrespondon një akti zyrtar dhe ku çdo shkëputje në varg indikon një akt të pabotuar. Kjo hallkë verifikimi i jep përgjigje pyetjes "sa" akte zyrtare (ligje, vendime, udhëzime etj.) mungojnë në FZ dhe sa jo.
2. **Faktike** - Kryqëzimi i gjetjeve nëpërmjet ballafaqimit të dy burimeve zyrtare ku arkivohen akte. Kjo synon t'i japë përgjigje pyetjes "cilat" akte zyrtare (konkretisht) nuk janë botuar në FZ (atribute, titull dhe përmbajtje).

Sa i takon VKM-ve, procesi monitorues ndjek një protokoll relativisht të komplikuar. Kjo sepse, Qeveria nxjerr VKM edhe në rastin kur miraton në parim një marrëveshje apo edhe kur propozon një projektligj. Këto të fundit, fjala vjen, duhen ratifikuar nga Kuvendi para se të dërgohen për botim në Fletore Zyrtare. Kjo do të thotë se, destinacioni final nuk është gjithmonë i njëjtë për aktet që nxjerr KM: ca janë definitive dhe shkojnë për botim në FZ, ca të tjera janë jo-definitive (tranzitore) dhe kalojnë për miratim të mëtejshëm në Kuvend ose nga vetë KM. Në rastin e VKM-ve, përpara se të aplikohen të dyja hallkat metodologjike, identifikohen me kujdes dhe veçohen të gjitha ato VKM, destinacioni i të cilave nuk është Fletorja Zyrtare (marzhi i gabimit njerëzor: 5%)

Po ashtu, një vështirësi relative paraqet edhe verifikimi i mungesave në FZ i udhëzimeve të ministrave. Metodologjia ÇIP parashikon edhe në këtë rast një protokoll specifik verifikimi, që kufizohet kryesisht në aplikimin e hallkës **Skematike**, ku çdo mungesë në vargun indeksues për secilën ministri është automatikisht një udhëzim i pabotuar në FZ.

Hallka **Faktike** e verifikimit, në rastin e udhëzimeve, aplikohet vetëm aty ku është e mundur sepse, ndryshe nga siti zyrtar i KM, sitet zyrtare të ministrave nuk publikojnë me rregullsi të kënaqshme udhëzimet respektive, edhe pse këto janë aktet kryesore zyrtare që ministrat nxjerrin gjatë ushtrimit të detyrës së tyre. Për të gjeneruar sa më shumë "lëndë të parë" që të jetë e mundur për verifikimin Faktik, përveç siteve zyrtare të ministrave, për ballafaqim të dhënash përdoret edhe çdo raport, strategji apo buletin qeveritar, i cili mund të ketë

referenca apo informacion për udhëzime të caktuara. Në rastin e udhëzimeve, ekziston gjithmonë mundësia që numri indeksues që mbyll serinë e botimit në FZ për një vit të dhënë kalendarik, të mos jetë në fakt i fundit apo përmblyllësi. Sa kohë që nisemi nga premisa se mund të ekzistojnë mangësi në botimin në FZ të udhëzimeve, duhet pranuar mundësia që mungesat të jenë të pranishme teorikisht edhe përtej shifrës që rezulton se mbyll serinë e vargut indeksues në FZ. Nëse gjatë hulumtimit në sitet zyrtare të ministrave (aty ku është e mundur), apo në dokumenta të tjera zyrtarë të organeve qëndrore të shtetit, përmes aplikimit të hallkës **Faktike** hasen udhëzime që indeksohen nga një numër më i lartë se ai i udhëzimit me shifrën më të lartë të botuar në Fletore Zyrtare, atëherë, përlogaritjet mbi mungesat në vargun indeksues do të bazohen tek shifra më e lartë e gjetur, dhe jo tek shifra më e lartë indeksuese e aktit në Fletore Zyrtare.

Një tjetër kufizim metodologjik në rastin e udhëzimeve diktohet edhe nga mungesa e një rregulli indeksues të unifikuar. Konstatohet se, ministratë shqiptare nuk përdorin të njëjtin parim indeksues për llojin e aktit: *Udhëzim*. Konkretisht, KM, ME, MASH, MPPTT, MMPAU, MBUK përdorin varg indeksues kalendarik, kurse MD, MSH, METE, MP-ÇSSHB përdorin varg indeksues jo-konvencional, me bazë protokollare. Për këto të dytat, do të përdoret vetëm hallka **Faktike** e verifikimit për aq sa është e mundur (hallka **Skematike** nuk mund të aplikohet fare në këtë rast). Rezultatet e gjeneruara në këtë mënyrë, duhen konsideruar "**të brishta**" metodologjikisht. Pavarësisht kësaj, gjetjet për udhëzimet e lëna jashtë botimit në FZ për këto ministri, nuk mund të jenë në asnjë rast më të vogla se ato që do të reklamohen më poshtë; përkundrazi, ato në çdo rast janë teorikisht më të mëdha.

Si burime kryesore verifikimi janë përdorur:

Fletoret Zyrtare 2010
Fletore Zyrtare Ekstra (burimi: www.qpz.gov.al)
Arkiva elektronike e QPZ (www.qpz.gov.al)
Websiti Zyrtar i KM (www.keshilliministrave.al)
Websitet zyrtare të ministrave
Dokumenta zyrtarë qeveritare, si raporte, strategji etj
Raporte dhe rekomandime të Avokatit të Popullit
Websiti zyrtar i Gjykatës Kushtetuese
Websiti zyrtar i Gjykatës së Lartë
Websiti zyrtar i GJEDNJ



ANEKS SPECIAL

TABELAT E VKM-ve, 2010

Për shkak të specifikës në terma të volumit dhe të interesit që përfaqësojnë, VKM-të e identifikuar si të lëna jashtë botimi në Fletorë Zyrtare 2010 do të grupohen në dy tabela të posaçme në **Aneksin 1** të këtij raporti monitorues.

TABELA 20 ka të renditura 25 VKM (me natyrë përfundimtare) të cilat janë identifikuar nga ÇIP si të pabotuara në Fletorë Zyrtare 2010 (ato gjenden të publikuar në sitin zyrtar të Këshillit të Ministrave, por jo në FZ).

TABELA 21 ka të renditura 54 VKM *për miratim në parim*, të cilat janë të publikuar në faqen zyrtare në internet të KM, por jo në Fletorë Zyrtare 2010. Për shkak të natyrës së tyre tranzitore, praktika sugje-

ron se këto VKM nuk dërgohen për botim në FZ. Nga ana tjetër, vetë ligji 9000, "*Për organizimin dhe funksionimin e KM*" nuk bën në asnjë diferencim të posaçëm sa i takon mos-botimit në FZ të këtyre VKM-ve.

Megjithatë, në respekt të informimit të publikut, por edhe të argumentave "**pro**" dhe "**kundër**" në këtë drejtim, autorët e monitorimit kanë grupuar në një tabelë të posaçme të gjitha VKM-të *për miratim në parim*, të cilat gjenden të publikuar në faqen e KM, por jo në Fletorë Zyrtare, 2010. Interpretimi nëse duhet apo jo të ishin këto VKM të botuar edhe në FZ, le të mbetet për monentnin një prerogativë e gjithsecilit që dëshiron të futet në këtë debat me karakter doktrinar.

TABELA 20

Nr. rendor	VKM të identifikuar konkretisht (titull dhe përmbajtje) të cilat nuk janë të botuara në Fletorë Zyrtare, 2010	Data e VKM	Hyrja në fuqi	Publikuar në
1	VENDIM PËR DHËNIEN NË PËRDORIM KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK TË DISA MJEDISEVE, NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK	07/04/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
2	VENDIM PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË PRONËS "ZYRA DOGANORE, DREJTORIA RAJONALE, GJIROKASTËR", NGA MINISTRIA E FINANCËS (DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE), TE MINISTRIA E BRENDSHME, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT	07/04/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
3	VENDIM PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË SHTETASIT BESNIK HERCEKU, NË ITALI	24/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
4	VENDIM PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË SHTETASIT KLITI KËRKHALLI, NË IZRAEL	24/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
5	V E N D I M PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË SHTETASIT FADIL MEHMETAJ, NË GJERMANI	24/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
6	V E N D I M PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR KRYEMINISTRINË, PËR PAGESËN E ZYRËS SË PNUD-IT, NË TIRANË	17/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
7	V E N D I M PËR MIRATIMIN E VLERËS SË NDIHMËS PËR DËMET E SHKAKTUARA NË OBJEKTE, PRONË PRIVATE, NGA RESHJET E SHIUT DHE PËRMBYTJET, NË QARQET SHKODËR DHE LEZHË	17/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM



Nr. rendor	VKM të identifikuar konkretisht (titull dhe përmbajtje) të cilat nuk janë të botuara në Fletore Zyrtare, 2010	Data e VKM	Hyrja në fuqi	Publikuar në
8	V E N D I M PËR DHËNIE FONDI FINANCIAR BASHKISË KRUJË TË QARKUT TË DURRËSIT, PËR ZBATIMIN E PROJEKTEVE EMERGJENTE, QË LIDHEN ME MARRJEN E MASAVE REHABILITUESE DHE MBROJTËSE NGA FATKEQËSI TË NDRYSHME	10/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
9	V E N D I M PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2010, PËR BASHKINË KUKËS, PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT REHABILITIMI I MBULESAVE TË PALLATEVE, NË LAGJEN NR.1, KUKËS	10/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
10	V E N D I M PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRGJITHSHËM ANALITIK TË PROJEKTEVE, QË DO TË PARAQITEN PËR SHQYRTIM NË KËSHILLIN E MINISTRAVE, GJATË VITIT 2010	10/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
11	V E N D I M PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK	10/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
12	VENDIM PER SHITESË FONDESH PËR AGJENCINË KOMBËTARE BËRTHAMORE	03/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
13	VENDIM PER HAPJEN E PËRFAQËSISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KUAJIT, SHTETI I KUAJITIT		Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
14	VENDIM PER DHËNIE FONDI FINANCIAR KOMUNËS PASKUQAN TË QARKUT TË TIRANËS, PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT EMERGJENT, RRËSHQITJA TE VARREZAT NË PASKUQAN , PËR MARRJEN E MASAVE REHABILITUESE DHE MBROJTËSE	03/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
15	V E N D I M PËR HAPJEN E PËRFAQËSISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BRATISLAVË, REPUBLIKA E SLOVAKISË	03/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
16	V E N D I M PËR ÇAKTIMIN E NUMRIT TË PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE TË PUNËMARRËSVE DHE TË PUNËDHËNËSVE NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË PUNËS	03/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
17	V E N D I M PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT, PËR AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT	24/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
18	V E N D I M PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË Z. SIMON LUSHAJ, NË TURQI	24/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
19	V E N D I M PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.88, DATË 15.2.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, VPËR PËRÇAKTIMIN E PËRBËRJES STRUKTURE DHE SHPËRBLIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË SPORTIT, TË NDRYSHUAR	24/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
20	V E N D I M PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E FINANCAVE, PËR KRYERJEN E RIKONSTRUKSIONIT TË AKADEMISË SË TRAJNIMEVE TË ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE	17/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
21	V E N D I M PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR INSTITUTIN E STATISTIKAVE, PËR KRYERJEN E RIKONSTRUKSIONIT TË NDËRTESES, NË ADMINISTRIM TË KËTJË INSTITUCIONI	17/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
22	V E N D I M PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT EKONOMIK E FISKAL TË SHQIPËRISË, 2010 -2012	27/01/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
23	V E N D I M PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË KOMUNËN TOPOJAN, TË QARKUT TË KUKËSIT	27/01/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
24	V E N D I M PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË NDIHMËS SHTETËRORE	27/01/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
25	V E N D I M PËR EMËRIM NË DETYRË	13/01/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
26	VENDIM PËR DHËNIEN NË PËRDORIM KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK TË DISA MJEDISEVE, NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK	07/01/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM



TABELA 21

Nr. rendor	VKM të identifikuara konkretisht (titull dhe përmbajtje) të cilat nuk janë të botuara në Fletore Zyrtare, 2010	Data e VKM	Hyrja në fuqi	Publikuar në
1	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT DHE PROJEKTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE, DHE UJËSJELLËS – KANALIZIME, POGRADEEC, SH.A.-JA, DHE KFË FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “	22/12/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
2	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË HUASË, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE, DHE UJËSJELLËS – KANALIZIME, POGRADEEC, SH.A.-JA, DHE KFË FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “MBROJTJA MJEDIS	22/12/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
3	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET, REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE, DHE KFË FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “INFRASTRUKTURA BASHKIAKE I, FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME PËR QYTETET	22/12/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
4	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT DHE PROGRAMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE DHE FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIM, DHE KFË FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “FONDI I INVESTIMEVE	22/12/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
5	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE, DHE KFË FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “INFRASTRUKTURA BASHKIAKE ”	22/12/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
6	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT DHE PROJEKTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE, DHE UJËSJELLËSIT, BERAT - KUÇOVË, SH.A., DHE KFË, FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN ME GRANT TË PROJEKTI	22/12/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
7	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT DHE PROGRAMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE DHE SHOQATA RAJONALE “KORÇA”, DHE KFË FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “ADMINISTRIMI I MBETJEVE	22/12/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
8	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË EUROPËS, PËR ZYRËN E KËSHILLIT TË EUROPËS NË TIRANË DHE STATUSIN E SAJ LIGJOR	22/12/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
9	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDRYSHUESE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AUSTRIËS, PËR REALIZIMIN E NJË SISTEMI KOMPJUTERIKPËRREGJISTRINTEMELTARTËGJENDJESCIVILENËSHQIPËRI	10/12/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
10	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË KREDISË SË EKSPORTIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE, QË VEPRON NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRFAQËSOHET NGA MINISTRIA E FINANCEVE, DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA, AG, PËR FINANCIMIN E PËRMI	10/12/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
11	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJEVE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR HAPJEN E PIKAVE TË PËRBASHKËTA TË KALIMIT NDËRKUFITAR BORJE – GLLOBOÇICË, ORGJOST (KUKËS) ORÇUSH	13/10/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM



Nr. rendor	VKM të identifikuar konkretisht (titull dhe përmbajtje) të cilat nuk janë të botuara në Fletore Zyrtare, 2010	Data e VKM	Hyrja në fuqi	Publikuar në
12	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË FEDERATËS RUSE, PËR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE FINANCIARE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, KUNDREJT FEDERATËS RUSE,	13/10/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
13	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E SIGURISË	06/10/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
14	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES FINANCIARE, NDËRMJET KFË, FRANKFURT AM MAIN, DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, (PËRFITUESI), PËR SHUMËN 975 475 EURO, PËR SHËRBIMET E EKSPERTIZËS SË M	13/08/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
15	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, NË KUADRIN E PROCESIT TË ANËRTARËSIMIT NË BASHKIMIN EUROPIAN	28/07/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
16	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË DANIMARKËS, PËR BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM	28/07/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
17	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA), PËR PROJEKTIN E TRANSPORTIT	28/07/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
18	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE URDHËRIT SOVRAN USHTARAK BAMIRËS TË SHËN GJONIT TË JERUZALEMIT, TË RODIT DHE MALTËS, PËR SHËRBIMIN POSTAR	07/07/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
19	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË, PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË NË RAST TË FATKEQËSIVE DHE AKSIDENTEVE TË MËDHA 22	07/07/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
20	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE URDHËRIT SOVRAN USHTARAK BAMIRËS TË SHËN GJONIT TË JERUZALEMIT, TË RODIT DHE MALTËS, PËR SHËRBIMIN POSTAR	07/07/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
21	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË KONVENTËS RAJONALE TË RREGULLAVE PREFERENCIALE TË ORIGJINËS PAN-EURO-MED	07/07/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
22	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA), PËR PROJEKTIN E MODERNIZIMIT TË SISTEMIT SHËNDETËSOR	07/07/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM



Nr. rendor	VKM të identifikuara konkretisht (titull dhe përmbajtje) të cilat nuk janë të botuara në Fletore Zyrtare, 2010	Data e VKM	Hyrja në fuqi	Publikuar në
23	VENDIM PER MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES "ISTISNA'A" DHE MARRËVESHJES SË AGJENCISË "ISTISNA'A", NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM (IDB), PËR PROJEKTIN "RINDËRTIMI I RRUGËVE DYTËSORE DHE L	30/06/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
24	VENDIM PER MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË HUASË, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM (IDB), PËR PJESËMARRJE NË FINANCIMIN E PROJEKTIT "RINDËRTIMI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE"	30/06/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
25	VENDIM PER MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF 096009, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "MBËSHTETJA E ZBATIMIT TË INICIAT	30/06/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
26	VENDIM PER MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROTOKOLLIT NR.3 TË KONVENTËS KUADËR EUROPIANE "PËR BASHKËPUNIMIN NDËRKUFITAR NDËRMJET BASHKËSIVE APO AUTORITETEVE TERRITORIALE NË LIDHJE ME GRUPIMET E BASHKËPUNIT EURORAJONAL"	16/06/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
27	VENDIM PER MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROTOKOLLIT SHITESË TË KARTËS EUROPIANE TË VETËQEVERISJES VENDORE PËR TË DREJTËN PËR TË MARRË PJESË NË PUNËT E NJË AUTORITETI VENDOR	16/06/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
28	VENDIM PER MIRATIMIN, NË PARIM, TË MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIMIN DHE MBËSHTETJEN PËR SEKRETARIATIN E KONVENTËS SË BASHKËPUNIT POLICOR TË EUROPËS JUGLINDORE	16/06/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
29	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROTOKOLLIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË TURQISË, PËR NJËSINË SHQIPTARE QË OPERON NËN KOMANDËN E FORCËS TURKE NË AFGANISTAN, BRENDA FUSHËS SË VEPRIMIT TË OPERACIONEVE TË F	09/06/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
30	VENDIM PER MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROTOKOLLIT NR.3 TË KONVENTËS KUADËR EUROPIANE "PËR BASHKËPUNIMIN NDËRKUFITAR NDËRMJET BASHKËSIVE APO AUTORITETEVE TERRITORIALE NË LIDHJE ME GRUPIMET E BASHKËPUNIT EURORAJONAL"	16/06/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
31	VENDIM PER MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROTOKOLLIT SHITESË TË KARTËS EUROPIANE TË VETËQEVERISJES VENDORE PËR TË DREJTËN PËR TË MARRË PJESË NË PUNËT E NJË AUTORITETI VENDOR	16/06/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
32	VENDIM PER MIRATIMIN, NË PARIM, TË MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIMIN DHE MBËSHTETJEN PËR SEKRETARIATIN E KONVENTËS SË BASHKËPUNIT POLICOR TË EUROPËS JUGLINDORE	16/06/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
33	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROTOKOLLIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË TURQISË, PËR NJËSINË SHQIPTARE QË OPERON NËN KOMANDËN E FORCËS TURKE NË AFGANISTAN, BRENDA FUSHËS SË VEPRIMIT TË OPERACIONEVE TË F	09/06/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
34	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË KONTRATËS FINANCIARE, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE (BEI), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE	20/05/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
35	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT, PËR SHËRBIMET AJRORE	20/05/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM



Nr. rendor	VKM të identifikuar konkretisht (titull dhe përmbajtje) të cilat nuk janë të botuara në Fletore Zyrtare, 2010	Data e VKM	Hyrja në fuqi	Publikuar në
36	V E N D I M PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË HUASË, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT OPEC PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (OFID), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE (FAZA II)	05/05/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
37	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJEVE DHE TË DOKUMENTEVE TË TRANSAKSIONIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRI I FINANCIVE, DHE DEUTSCHE BANK AG, LONDËR E J.P. MORGAN SECURITIES LTD, PËR EMETIM	07/04/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
38	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROTOKOLLIT DYPALËSH TË BASHKËPUNIMIT PËR ZHVILLIM, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË	07/04/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
39	V E N D I M PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT EUROPIAN, PËR PROGRAMIN KOMBËTAR 2009, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË ASISTENCËS SË PARAZGJERIMIT (KOMPONENTI P	17/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
40	V E N D I M PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT EUROPIAN, PËR PROGRAMIN HORIZONTAL PËR SIGURINË BËRTHAMORE DHE MBROJTJEN NGA RREZATIMET, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT	17/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
41	V E N D I M PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË HUNGARISË, PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK	17/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
42	V E N D I M PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKUT TË PALIGJSHËM NDËRKOMBËTAR	10/03/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
43	V E N D I M PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË HUASË, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (EBRD), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE	24/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
44	V E N D I M PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROTOKOLLIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË PORTUGALISË, PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES, MES REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EUROPIAN, PËR RIPRANIMIN	17/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
45	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SPANJËS PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT	10/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
46	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR PËR VITET 2006, 2007 e 2008, PËR PROJEKTET "LINJA UNAZORE 110 KV N	10/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM



Nr. rendor	VKM të identifikuara konkretisht (titull dhe përmbajtje) të cilat nuk janë të botuara në Fletore Zyrtare, 2010	Data e VKM	Hyrja në fuqi	Publikuar në
47	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES FINANCIARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE, "PËR PROGRAMIN NDËRKUFITAR SHQIPËRI – MALI I ZI, PËR VITIN 2009, TË KOMPONENTIT TË DYTË TË....	10/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
48	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET PALËVE NË TRAKTATIN E ATLANTIKUT TË VERIUT, PËR BASHKËPUNIMIN NË LIDHJE ME INFORMACIONIN ATOMIK.	10/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
49	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË KONVENTËS, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ESTONISË, PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT.	10/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
50	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE, PËR PROGRAMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR NDËRMJET GREQISË DHE SHQIPËRISË, PËR VITIN 2009,	10/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
51	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE, PËR PROGRAMIN ME SHUMË PËRFITUES PËR TEMPUS, NË KUADËR TË KOMPONENTIT TË IPA-S, "ASISTENCE...	10/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
52	VENDIM PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT,	10/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
53	VENDIM PER MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR RIPROGRAMIMIN E FONDEVE TË MBETURA, PREJ 800 000 EURO-SH, NGA PROJEKTI "FURNIZIMI ME UJË..	03/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM
54	V E N D I M per MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË,PËR SHKËMBIMIN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR.....	03/02/2010	Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	Faqja zyrtare e KM



